

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5923  
E mërkurë, 6 nëntor 2019  
çmimi 0.40 €

## Vazhdon kampanja vetëdijesuese kundër trafikimit të qenieve njerëzore



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



NË TREVJETORIN E VDEKJES SË ASTRIT DEHARIT MIJËRA QYTETARË KANË MARSHUAR ME MOTON "NJË POPULL PËR DREJTËSI" | FAQE 4-5

# KËRKOHET DREJTËSI PËR ASTRIT DEHARIN



Mijëra qytetarë kanë marshuar të martën në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë për të kërkuar drejtësi për vdekjen e Astrit Deharit. Marshi me moton "Një popull për drejtësi" është mbajtur me rastin e trevjetorit të vdekjes së aktivistit të Lëvizjes


Vetëvendosje, Astrit Dehari, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, në rrethana të dyshimta. Qytetarët kanë kërkuar nga institucionet që t'i zbardhin rrethanat e vdekjes së Astritit dhe përgjegjësit e saj të dalin para drejtësisë. Gjatë këtij marshi qytetarët

kanë mbajtur në duar pankartat me mbishkrimet "Unë jam Astriti", "Drejtësi për Astritin", "Drejtësi". Para të pranishmëve ka folur lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, duke kërkuar hetim të ri, të pavarur dhe profesional për Astrit Deharin

## OPINION

DHUNËTARËT E HISTORISË F. 10-11

Rexhep QOSJA



## AKTUALE



SUPREMJA VENDOS PËR NUMËRIMIN E 1 806 PAKOVE ME FLETËVOTIME NGA DIASPORA F. 3

HARADINAJ: RECIPROCITETI IDE E MIRË, POR TAKSA NUK DUHET TË HIQET F. 3


## EKONOMI

BE-ja DO T'I PËRKRAHË NDËRMARRJET DHE ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE ME 3.5 MILIONË EURO F. 9

OAK-u SHPREH SHOQËTËSIM PËR RRIJTJEN E TARIFAVE NGA BANKAT KOMERCIALE F. 8

## KULTURË

'SENSORËT' POETIKË TË LULZIM TAFËS F. 14-15



BERAT ARMAGEDONI

## Qeveria miraton vendimin për kursime dhe ndarje të mjeteve buxhetore



Qeveria në detyrë e Kosovës të martën ka aprovuar vendimin për kursimet dhe ndarjet buxhetore ndërmjet organizatave buxhetore për vitin 2019 në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për këtë vit. Me këtë rast, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka vlerësuar se vendimi do ta sigurojë vazhdimin e mbështetjes dhe përkujdesjes në veçanti për kategoritë sociale



Kosova bëhet gati t'i kthejë edhe rreth 100 persona të tjerë të mbetur në Siri

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijibiznesi.com  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Osmani takohet me Hahnin

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kandidatja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministre, Vjosa Osmani, është takuar në Bruksel me komisionarin evropian për

politikat e fqinjësisë dhe zgjerimit, Jonnahes Hahn.

Osmani dhe Hahn kanë diskutuar për sfidat që e presin Kosovën dhe reformat e nevojshme për përsh-

pejtimin e integritit evropian të Kosovës.

"Me ftesë të komisionarit Johannes Hahn, sot zhvilluam takim në Bruksel për të diskutuar

për sfidat që e presin Kosovën dhe reformat e nevojshme për përshpejtimin e integritit evropian të vendit tonë", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook".



# Sassoli: Maqedonia e Veriut nuk mori një 'Jo' definitive për hapjen e negociatave

Kryetari i Parlamentit Evropian, David Sassoli tha se e rëndësishme është që pjesa më e madhe e shteteve të Bashkimit Evropian janë të bindura se procesi i nisjes së negociatave për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut, duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur

SHKUP, 5 NËNTOR - Kryetari i Parlamentit Evropian, David Sassoli, para deputetëve Parlamentit të Maqedonisë së Veriut ka theksuar se duhet kuptuar qartë se Bashkimi Evropian, nuk ka thënë 'Jo' për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë dhe se nuk bëhet fjalë as për gabim historik, por siç u shpreh ai, në këtë rast ka të bëjë me një ngecje, një pezullim, por që shteti do ta vazhdojë sërish rrugën në proceset integruese.

Ai njëherësh në fjalën e tij para deputetëve ka porositur autoritetet e vendit që të fokusohen në përshpejtimin e dinamikës së realizimit të reformave që i janë vendosur si

detyrim vendit nga Brukseli.

Për kryetarin e Parlamentit Evropian e rëndësishme është që pjesa më e madhe e shteteve të Bashkimit Evropian janë të bindura se procesi i nisjes së negociatave për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut, duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

"Ne kemi pasur, siç e dini, disa vërejtje dhe rezerva të cilat tashmë i kemi deklaruar, nga ana e disa shteteve, por ne jemi të bindur se mendimet e tyre në këtë moment do të shqyrtohen sërish dhe ngaqë zhgënjimi që u pasua në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri nuk duhet të na ndjekë. Kjo duhet të tejkalohet me guxim sepse



ne duhet ta përcaktojmë më mirë hapësirën e Bashkimit Evropian", tha ai.

"Ju e dini se Ballkani Perëndimor është në atë hapësirë. Kemi histori të përbashkët dhe ndjeja të përbashkëta. Në aspekt natyror, kjo do të jetë fuqia jonë, do të jetë trashëgimia jonë, e cila do t'u takojë të rinjve të Maqedonisë së Veriut, të cilët procesin e integritit në BE e shohin si

proces natyror", ka theksuar kryetari i Parlamentit Evropian, David Sassoli.

Ai tha se deputetëve maqedonas nuk duhet të ndjejnë keqardhje që votuan për ndryshimin e emrit të shtetit, pasi siç theksoi Sassoli, ky vendim ishte një hap i rëndësishëm për të ardhmen e Maqedonisë së Veriut.

Ndërkaq, kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, tha se mbështetja që

vjen nga Brukseli paraqet një indikator të qartë se vendi ndodhet në rrugën e duhur dhe kjo gjë inkurajon që institucionet të vazhdojnë realizimin e reformave.

Xhaferi u shpreh se për Maqedoninë e Veriut nuk ka asnjë alternativë tjetër përveç integritit në familjen evropiane.

"Pritjet nga samiti i BE-së në muajin maj janë se ky gabim historik do të përmirësohet dhe ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë si deri më tani me Parlamentin Evropian, përmes formës së komitetit të përzier parlamentar dhe nëpërmjet dialogut të njohur si Jean Monnet", tha ai.

"Do të jemi konsekuentë ndaj procesit të Berlinit si komplementar në procesin e integrujes dhe nuk do të pranojmë asnjë alternativë tjetër për anëtarësimin e plotfuqishëm të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian", tha Xhaferi.

## Basha: Dështimi me negociatat, dështim personal i Ramës



TIRANË, 5 NËNTOR - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, deklaroi gjatë një bashkëbisedimi me të rinjtë në Korçë se dështimi me negociatat është dështim personal i kryeministrit Edi Rama.

"Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Evropa nuk është një slogan por një punë e jashtëzakonshme. E kemi nisur këtë punë prej 30 vjetësh, por ka 5 vjet që kjo rrugë

është bllokuar. Dështimi me negociatat është dështim personal i Ramës. Vetëm vitin e kaluar kanë ikur në emigracion 38 mijë të rinj. Modeli që po na qeveris është modeli i gabuar", tha Basha.

Kreu demokrat nënvizoi se zotimi i PD-së është të kthejë shpresën dhe të ndërtojë këtu në Shqipëri të ardhmen tonë. Basha foli edhe për arsimin, duke

u shprehur se 120 milionë euro jepen për koncesione për 12 veta dhe nuk sjellin asnjë dobi, ndërsa do të mjaftonin 70 milionë euro për të bërë ndryshim në arsim.

"Ky është plani ynë. Mbështetjet për universitetet dhe për studentët në nevojë. Qeveria i ka mundësitë të paguajë taksën e studimit, por zgjedh që këto para t'ua japë 12 personave", tha Basha.

## Roth: Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria i plotësuan kushtet

BERLIN, 5 NËNTOR - "Bashkimi Evropian e tha fjalën e tij, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë përmbushur kushtet e përcaktuara nga Brukseli dhe ato i përkasin Evropës, kështu që është fatale të lëmë hapësirën për aktorë të tjerë si Rusia, Kina apo Turqia", ka shkruar ministri gjerman për Çështjet Evropiane, Michael Roth në një opinion për gazetën "Die Welt".

"Po, ne duhet të reformojmë Bashkimin Evropian. Por, thellimi i vonuar i BE-së nuk është në kontrast me zgjerimin e tij. Një Bashkim Evropian më i madh, që është në të njëjtën kohë më i aftë, më sovran dhe më demokratik, mund të krijojë më shumë siguri për njerëzit e tij. Prandaj, presidenti në largim i Komisionit të BE-së, Juncker, ka mjaft të drejtë kur thotë se "është

një gabim historik që liderët e BE-së refuzuan më 18 tetor dritën jeshile për përfshirjen e planifikuar të bisedimeve të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë".

Toth tha se kjo dështoi për shkak të unanimitetit të kërkuar. Shtyrja e një votimi pozitiv shkaktoi një habi si në Ballkan ashtu edhe në BE, sepse BE-ja u qëndron fjalëve.





# Qeveria miraton vendimin për kursime dhe ndarje të mjeteve buxhetore

Qeveria në detyrë e Kosovës të martën ka aprovuar vendimin për kursimet dhe ndarjet buxhetore ndërmjet organizatave buxhetore për vitin 2019 në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për këtë vit. Me këtë rast, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka vlerësuar se vendimi do ta sigurojë vazhdimin e mbështetjes dhe përkujdesjes në veçanti për kategoritë sociale

**EPOKA ERE** **Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 5 NËNTOR** - Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e së martës, me kërkesë të Ministrisë së Financave, ka miratuar vendimin për kursimet dhe ndarjet buxhetore ndërmjet organizatave buxhetore për vitin 2019 në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për këtë vit.

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se vendimi është hartuar në bazë të kursimeve të deklaruara nga organizatat buxhetore për mjetet financiare për vitin 2019 dhe ka për qëllim ta ngritë efikasitetin e

ekzekutimit të buxhetit në përmbyllje të këtij viti fiskal. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se vendimi do ta sigurojë vazhdimin e mbështetjes dhe përkujdesjes në veçanti për kategoritë sociale. Ai ka thënë se nëse vonohet edhe më tej formimi i qeverisë do të mbahet edhe një mbledhje e ardhshme e qeverisë në detyrë. "Në rast se vonohet formimi i qeverisë së re unë ju kisha ftuar ta mbajmë edhe një mbledhje tjetër të qeverisë në detyrë, sepse ka tema që nuk mund të presin shumë. Deklarohuni me votë se a jeni edhe për një mbledhje të qeverisë ku ka çështje me prioritet", ka deklaruar Haradinaj.

Në këtë mbledhje të qeverisë

është bërë me dije se janë evidentuar mbi 31 milionë euro të kursyera nga organizatat buxhetore dhe ato do të shpërndahen në Ministrinë e Punëve dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës dhe në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore.

Po në mbledhjen e së martës qeveria ka shqyrtuar Raportin e thesarit për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën nëntëmuajore të vitit 2019.

Ky raport evidenton se në këtë periudhë janë realizuar të hyra të përgjithshme në vlerë prej 1 miliard e 676 milionë eurosh, ndërsa shpenzimet janë në vlerën 1 miliard e 407 milionë euro.

Qeveria në detyrë ka ndarë mjete në vlerë prej 42 mijë eurosh për angazhimin e ekspertëve që do të punojnë në përfitimin e fondeve nga projektet e Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC).

Po në këtë mbledhje është

## Haradinaj: Reciprociteti ide e mirë, por taksa nuk duhet të hiqet

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, pas mbledhjes së qeverisë ka mbajtur një konferencë me gazetarë, në të cilën ka thënë se taksa është një ndër temat që ka konsoliduar Kosovën. Sipas tij, reciprociteti me Serbinë është ide e mirë, por taksa nuk duhet të hiqet. "E pëlqej idenë e reciprocitetit, por për aspekte të tjera. Taksa nuk duhet të hiqet, po habitem me disa që thonë ashtu. Kushdo që shkon asaj rruge i bën dëm edhe vetes, edhe Kosovës. S'ka reciprocitet deri në njohje nga Serbia", është shprehur Haradinaj.

Në këtë konferencë kryeministri në detyrë ka thënë se nuk ka ndonjë informata se kur mund të ndodhin arrestimet e para nga Gjykata Speciale. Madje ai ka theksuar se do të ishte mirë të pyeten rreth arrestimeve të mundshme ata që e kanë votuar këtë gjykatë. "Për arrestimet nuk di asgjë. Më mirë t'i pyesni ata që e kanë votuar gjykatën. Ndoshta ata i dinë më mirë procedurat, sepse unë s'kam informata. Ata që e kanë votuar e që thoshin është e nevojshme, është mirë t'i pyesni çfarë mendojnë sot", ka theksuar Haradinaj.

aprovuar vendimi për rivarrimin e dëshmorëve të kombit, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Bahri Fazliu

dhe Agron Rrahmani, në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në Velani.



## Kosova bëhet gati t'i kthejë edhe rreth 100 persona të tjerë të mbetur në Siri

**PRISHTINË, 5 NËNTOR** - Qeveria e Kosovës është duke bërë përgatitjet e fundit për t'i kthyer në Kosovë rreth 100 kosovarë të tjerë të cilët gjenden në Siri. Kështu ka thënë ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa.

Në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", ministri në detyrë, Mustafa, ka thënë se nuk

mund të japë shumë hollësi, por aktualisht po zhvillohen bisedime me Turqinë rreth kthimit të këtyre personave. "Në detaje nuk mund të prononcohem. Por, tash jemi shumë të interesuar me shtetin turk, mos ndonjë nga personat (kosovarët) që kanë qenë nëpër kampe ka kaluar në pjesën turke. Përafërsisht dihet numri, por nuk është numër i

madh tash, sepse 110 i kemi sjellë në Kosovë. Aty diku sillet edhe numri i personave të tjerë (që pritet të kthehen)", ka deklaruar Mustafa.

Në muajin prill të këtij viti institucionet kthyen në Kosovë 110 kosovarë, në mesin e tyre katër luftëtarë që ishin pjesë e organizatave terroriste në Siri, 32 gra dhe 74 fëmijë.





Në trevjetorin e vdekjes së Astrit Deharit mijëra qytetarë kanë marshuar me moton "Një popull për drejtësi"

# Kërkohet drejtësi

Mijëra qytetarë kanë marshuar të martën në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë për të kërkuar drejtësi për vdekjen e Astrit Deharit. Marshi me moton "Një popull për drejtësi" është mbajtur me rastin e trevjetorit të vdekjes së aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, në rrethana të dyshimta. Qytetarët kanë kërkuar nga institucionet që t'i zbardhin rrethanat e vdekjes së Astritit dhe përgjegjësit e saj të dalin para drejtësisë. Gjatë këtij marshi qytetarët kanë mbajtur në duar pankartat me mbishkrimet "Unë jam Astriti", "Drejtësi për Astritin", "Drejtësi". Para të pranishmëve ka folur lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, duke kërkuar hetim të ri, të pavarur dhe profesional për Astrit Deharin



EPOKA E RE  
Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Me moton "Një popull për drejtësi" të martën në Prishtinë është mbajtur marshi protestues nga sheshi "Skënderbeu" deri te Prokuroria Speciale për të kërkuar drejtësi për vdekjen e dyshimtë të aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 5 nëntor të vitit 2016. Gjatë këtij marshi mijëra qytetarë kanë mbajtur në duar pankartat me mbishkrimet "Unë jam Astriti", "Drejtësi për Astritin", "Drejtësi", duke kërkuar nga institucionet përkatëse që të zbardhen rrethanat e vdekjes së Astritit dhe përgjegjësit e saj të dalin para drejtësisë.

Bashkë me familjen Dehari, kryetarin e Vetëvendosjes, Albin Kurti, është rreshtuar edhe kryetari i Aleancës për Shqiptarët

nga Maqedonia e Veriut, Zijadin Sela. Në këtë marsh kanë marrë pjesë edhe ish-bashkëpartiakët e Astritit, Shpend Ahmeti, Visar Ymeri dhe anëtarë të tjerë nga PSD-ja.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka mbajtur fjalim para të pranishmëve, duke thënë se tri vjet pa Astritin janë shumë. "Tri vjet padrejtësi janë tepër shumë për Xhemilen dhe Avniun, Artën dhe Arsën, Albanën, Lumin dhe Blinin. Janë tepër shumë për juve, për neve, për secilin për ne dhe të gjithë ne", ka thënë Kurti, duke shtuar se janë tronditur të gjithë me vdekjen e Astritit. "Jemi tronditur tepër shumë kur mësuam që s'do ta shohim. Në qelinë A3, kur kam qenë edhe unë para 12 vjetëve, e kanë mbytur një njeri të pafajshëm. Ekspertiza ligjore ka konstatuar qysh atëherë që për 11 lloje të drogave janë zhvilluar teste dhe në asnjërin prej tyre Astriti nuk

ka dalë pozitiv. Janë zhvilluar teste dhe nuk kanë gjetur kurrfarë medikamenti, trup i shëndoshë plotësisht në aspektin fizik dhe psikik", ka deklaruar Kurti. Ai ka thënë se të mbahet në paraburgim një qytetar për 68 ditë pa u intervistuar asnjëherë është së paku tendencë për izolim dhe kursesi përpjekje për drejtësinë. Kurti ka thënë se nevojitet një hetim i ri, i pavarur dhe profesional jo vetëm për mbytjen e Astritit, por edhe procesin trevjeçar. Sipas tij, mbi Astritin është kryer krimi prej

ditës kur është arrestuar. "Nuk ka pasur të vërtetë për drejtësi, por një qëllim tendencioz që është vënë prioritet ndaj të dhënave faktike. Nevojitet një hetim i ri, i pavarur dhe profesional jo vetëm për mbytjen e Astritit, por edhe për procesin trevjeçar. Astriti u mbyt nga regjimi sepse nuk po e merrte në pyetje. Mbi Astritin është kryer krimi prej ditës kur është arrestuar", është shprehur Kurti.

Kurse Rreze Hoxha, përfaqësuese e shoqërisë civile, ka kërkuar nga shteti që të vihen para drejtësisë dhe fajtorët të japin përgjegjësi për këtë rast. "Fatkeqësia që ra mbi Astritin është shembull fatkeq i dështimit të shtetit për mbrojtjen e tij në Qendrën e Paraburgimit. Këto tri vjet kanë qenë të vështira për të gjithë ne. Tri vjet familjarëve të tij u është mohuar e drejta për të vërtetën. Publikimi i raportit të Zvicrës i ka dhënë të drejtë familjes për hetim. Në këtë marsh kërkojmë që shteti të vihet para përgjegjësisë për Astritin që u burgos", ka deklaruar ajo.

Ndërsa profesoresha në Fakultetin e Mjekësisë, Hatixhe Pupovci, duke përmendur kontributin e Astrit Deharit, ka thënë se vdekja e tij do të mbetet një njollë e zezë për sistemin e drejtësisë. "Ai dha shembull si duhet të luftohet për kauzat. Astritin e njoha në Fakultetin e Mjekësisë, ishte djalë i buzëqeshur, aktivist i shkëlqyer. Bashkë protestuam

për një universitet më ndryshe, i zhveshur nga format e korrupsionit. Astrit Dehari u vra në duar të shtetit, në institucion, në vendin ku s'ka guxuar të ndodhë diçka e tillë. Astriti u vra për të dytën, tretën e katërtën herë. Ndaj tij është kryer krim i shtrembërimin të vërtetë të vrasjes", është shprehur Pupovci. Kurse në emër të familjes Dehari, Destan Dehari ka kërkuar drejtësi për Astrit Deharin.

Lideri i Partisë Socialdemokrate (PSD) dhe kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, e ka përkujtuar Astrit Deharin në trevjetorin e vdekjes së tij, duke thënë se Astriti ishte aktivist politik, aktivist i LV-së, student shembullor dhe për një kohë edhe punëtor shembullor në Komunën e Prishtinës. "Përveç temave të drejtorisë së shëndetësisë, vinte tek unë në zyrë gjithmonë kur kishte takuar ndonjë qytetar në hall nga gjendja ekonomiko-sociale dhe mendonte se duhet t'i ndihmojmë. E shihte si qëllim jetësor ndihmën për njerëzit në nevojë. Vdekja e tij në burgun e Prizrenit, ku ishte dërguar dhe mbajtur padrejtësisht, mbetet e pasqaruar. Kjo është barrë jo vetëm për pushtetin e atëhershëm politik e administrativ, por barrë për secilin qytetar të Republikës. Barra dhe përgjegjësia veçse do të shtohen deri të zbulohen rrethanat dhe përgjegjësit e asaj çfarë ka ndodhur. Por, sot, në





# për Astrit Deharin



trevjetorin e vdekjes së hershme të Astritit, ta kujtojmë Astritin për njeriun që ishte, modest, punëtor, zë i butë për miqtë, e zë i fortë për drejtësi e barazi. Shpirti ndjesë i pastë!", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar Astrit Deharin në trevjetorin e ndarjes nga jeta. Haradinaj ka thënë se bashkëndien me familjarët, miqtë dhe bashkëpunëtorët dhe se marshi i sotëm për Astritin është thirrje e ndërgjegjes kolektive për të vërtetën. "Në trevjetorin e ndarjes nga jeta të Astrit Deharit, bashkëndiej me familjarët, miqtë dhe bashkëpunëtorët, duke e ndarë dhimbjen me ta për këtë rast tragjik. Marshi i sotëm 'Një popull për drejtësi' është thirrje e ndërgjegjes kolektive për të vërtetën", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Në shenjë kujtimi për Astrit Deharin dhe në shenjë proteste për moszbardhjen e vdekjes së tij, Komuna e Prishtinës në mënyrë simbolike të martën në orën 14:00 ka ndalë të gjitha shërbimet me palë për pesë minuta. "Këto pesë minuta do të jenë minuta të shprehjes së respektit e kujtimit për kolegun tonë Astrit Dehari. Gjithashtu, le të jetë kjo edhe porosi se jeta në Republikën e Kosovës nuk mund të vazhdojë normalisht pa u zbardhur në tërësi rasti Dehari", është thënë

në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Po të martën janë ndezur qirinjtë dhe vendosur kurora me lule në Prizren, pranë muralit të Astrit Deharit.

## Në Fakultetin e Mjekësisë përurohet një pushimore për nder të Astrit Deharit

Aktivistët e Lëvizjes Studentore "Studim, Kritikë Veprim" kanë nderuar ish-studentin e mjekësisë, Astrit Deharin, duke përuar një pushimore në bibliotekën e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Disa karrige dhe tavolina druri janë vendosur para bibliotekës së këtij fakulteti derisa në sfond qëndron portreti i Astritit. Sipas organizatorëve, arsyeja e vendosjes së kësaj pushimore pranë bibliotekës është sepse Astriti kohën më të madhe e ka kaluar brenda saj.



## Homazhe në përkujtim të trevjetorit të vdekjes së Astrit Deharit

Familjarët e Astrit Deharit dhe aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, të prirë nga kryetari Albin Kurti, të martën kanë bërë homazhe pranë varrit të Astrit Deharit në trevjetorin e vdekjes së tij. Me këtë rast, zyrtari i LV-së, Glauk Konjufca, ka thënë se Astriti ishte aktivist i dalluar i

Vetëvendosjes, i dashur me popullin, i vendosur me qëndrimin e i palëkundur me idealin që e kishte. Duke konstatuar se në dritën e ekspertizës së re, Astriti humbi jetën nga një krim, i cili duhet të zbulohet dhe kriminelët duhet të sillen para drejtësi, Konjufca ka theksuar

se jeta e një individi merr statusin e vet sublim atëherë kur arrin të shndërrohet në një simbol të së mirës së përgjithshme, e Astriti e ka arritur këtë status. Ndërkaq babai i Astritit, Avni Dehari, në emër të familjes ka falënderuar të pranishmit për mbështetjen e vazhdueshme.





## Fillojnë punimet për ndërtimin e objektit të ri të administratës komunale në Lipjan

LIPJAN, 5 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka vendosur të martën gurthemelin për ndërtimin e objektit të ri të administratës komunale. Me këtë rast, ai ka thënë se objekti i ri do t'i përmbushë nevojat e punëtorëve të administratës së kësaj komune. "Është një projekt i

rëndësishëm për të gjithë qytetarët e Komunës së Lipjanit. Jam i lumtur që sot po fillojmë ta jetësojmë këtë projekt në hapësirën e barakave shumë të vjetruara, tashmë të rrënuara. Do të ndërtojmë një objekt të ri, që i përmbush të gjitha nevojat për punëtorët e administratës komunale si dhe do të ofrojë

qasje më të lehtë dhe shërbime moderne për qytetarët", është shprehur Ahmeti, duke falënderuar Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për bashkëfinancimin e këtij projekti madhor. Ky projekt do të kushtojë 1 786 556 88 euro. Komuna e Lipjanit do ta mbështesë 40 përqindëshin e kësaj shume.



## Haziri: Prioriteti im, banimi social

GJILAN, 5 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka mbajtur të martën takimin e dytë me qytetarë, në të cilin ka thënë se objektivi e qeverisjes së tij vazhdon të mbetet realizimi i projekteve infrastrukturore në qytet dhe në fshatra, që përfshin ndërtimin e rrugëve, ujësjellësve, kanalizimeve, ndriçimin publik dhe trotualet. Duke i paraqitur sukseset dhe sfidat e qeverisjes gjatë kësaj periudhe dhjetëmuajore, Haziri ka nënvizuar faktin se kjo periudhë është përcjellë me suksese sa iu përket investimeve dhe realizimit të projekteve, por edhe me sfida, ndër të cilat, më kryesorja ka qenë dhe vazhdon të jetë kriza e ujit të pijes. "Gjilani është përballur me sfidën e madhe të ujit të pijshëm që nga qershori e tutje si pasojë e mungesës së reshjeve jo vetëm këtë verë, por edhe në dy-tri vjetët e fundit", ka thënë Haziri. Ai ka folur edhe për masat që janë ndërmarrë për ta përballuar krizën e ka cila ka imponuar nevojën për shpalljen e gjendjes emergjente, ndërkohë që është



organizuar edhe konferenca mbi sfidat dhe alternativat e furnizimit të qëndrueshëm me ujë, me pjesëmarrje të të gjithë

resorëve nga niveli qendror. Ishte vlerësim në konferencë, se nevojiten 460 mijë euro për përballimin e krizës, por shpër-

bërja e Kuvendit të Republikës dhe rënia e qeverisë i bllokoi projektet për daljen nga kjo gjendje emergjente dhe komu-

na, në bashkëpunim me kompaninë 'Hidromorava', u detyrua të ndajë 200 mijë euro për hapjen e puseve të reja te lokacioni i FSK-së dhe Lagjja Fidanishte, të cilat pritet ta zbusin gjendjen.

Duke folur për angazhimet e tjera, kryetari Haziri ka thënë se prioritet gjatë kësaj periudhe i është dhënë banimit social, ku së bashku me donatorët janë ndërtuar 25 shtëpi për familjet pa kullm mbi kokë, ndërkohë që edhe pesë shtëpi të tjera janë në proces të ndërtimit, ose gjithsej deri tani janë ndërtuar 113 shtëpi për familjet në nevojë. "Po ashtu, një numri tjetër të familjeve me gjendje të rëndë sociale iu paguhet qiraja e banimit. Në Gjilan, në përfundim e sipër është edhe fshati social, donacion nga Kuvajti, në vlerë 2.5 milionë dollarë, ku përfshihen 12 objekte për pleq, për nëna pa përkujdesje dhe fëmijë jetimë. Aktualisht në Gjilan jetojnë 22 pleq të pambrojtur, por në të ardhmen ky numër pritet të rritet shkak i migracionit", ka thënë Haziri.

## Elezaj nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Bashkësinë Islame

KLINË, 5 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkësinë Islame të Kosovës (BIK). Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja e Komunës së Klinës, përkatësisht Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjente nga ana e Bashkësisë Islame të Kosovës, Dega në Klinë, për përcaktimin e radhëve të varrezave në qytetin e Klinës, si dhe varrosjen e të vdekurve

sipas radhës dhe kohës së varrimit. Lidhur me këtë marrëveshje Komuna e Klinës ia lejon Bashkësisë Islame të Kosovës, Dega në Klinë, t'i menaxhojë varrezat në qytetin e Klinës, duke mos lejuar që të caktohen vendet paraprakisht, por me qëllim që të shfrytëzohen hapësirat me radhë. Marrëveshja e bashkëpunimit është lidhur me vullnetin e dy palëve për periudhën dyvjeçare, me mundësi vazhdimi.



## Obiliqi dhe Fushë-Kosova diskutojnë për shndërrimin e zonës së hirit në park

Obiliqi, 5 nëntor (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka takuar kryetarin e Komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, me

të cilin ka diskutuar për planet ndërkomunale dhe mundësitë për shndërrimin e zonës së hirit në park. "Me kolegun Burim Berisha,

kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës, diskutuam për planet ndërkomunale, mundësitë për shndërrimin e zonës së hirit në

park, si dhe për bashkëpunime të tjera në interes të të dy komunave", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook".





## Supremja vendos për numërimin e 1 806 pakove me fletëvotime nga diaspora

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Gjykata Supreme ka marrë vendim në favor të Lëvizjes Vetëvendosje për numërimin

edhe të 1 806 pakove me fletëvotime nga diaspora. Lajmin e ka bërë me dije anëtarja e Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin

Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nazlie Bala. "Sapo na erdhi lajmi i mirë: Gjykata Supreme e miratoi ankesën e Lëvizjes

Vetëvendosje për t'i numëruar edhe 1 806 pakot e fundit me fletëvotime nga mërgata", ka shkruar Bala.



## Vazhdon kampanja vetëdijesuese kundër trafikimit të qenieve njerëzore

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Në kuadër të kampanjës vetëdijesuese kundër trafikimit të qenieve njerëzore, që është duke u mbajtur në Kosovë, Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, në mbështetje të Terre des Hommes, të martën ka organizuar në Prishtinë tryezën që për qëllim ka pasur fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke përfshirë edhe bashkësitë fetare. Pjesëmarrës në këtë tryezë kanë qenë përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, si zyrtarë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyra e Avokatit të Popullit, ndërsa nga bashkësitë fetare të pranishëm kanë qenë zyrtarë nga kryesia e Bashkësisë Islame (BIK), zyrtarë nga kisha ortodokse serbe në Kosovë, si dhe organizatat joqeveritare Terre des Hommes dhe Caritas Kosova.

Hapja e tryezës u bë nga Policia e Kosovës, duke paraqitur trendin



e trafikimit dhe rëndësinë e bashkëpunimit për ta parandaluar këtë dukuri, pastaj secili nga pjesëmarrësit bëri një prezantim nga këndvështrimi i

institucionit që përfaqësonte, duke e vlerësuar lart organizimin e tryezës dhe nevojën e domosdoshme për bashkëpunim. Tryeza ka vazhduar me prezantim

e statistikave, zhvillimin e debatit dhe nxjerrjen e rekomandimeve. Gjatë kësaj tryeze u parashtrua nevoja dhe gatishmëria e secilit që ta fuqizojë bashkëpunimin

dhe të jetë pjesëmarrës aktiv në të gjitha aktivitetet qendrore dhe lokale për parandalimin e kësaj dukurie si një e keqe që rrezikon vendin tonë.

## Ekstradohet me sukses i dyshuari malazez për vrasje të rëndë

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, përmes kësaj komunikate për media ka njoftuar se është realizuar me sukses ekstradimi i Mario Miloseviçit, i kërkuar nga autoritetet malazeze si i dyshuar për vrasje të rëndë dhe mbajtje të paautorizuar të materialeve plasëse. "Falë punës që kemi bërë si Ministri e Drejtësisë në rrafshin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar sot, më datë 5 nëntor 2019, është realizuar me



sukses ekstradimi i njërit prej personave më të kërkuar nga Mali i Zi, i dyshuari Mario Miloseviç, shtetas i Republikës së Malit të Zi. I dyshuari Miloseviç ishte i kërkuar nga autoritetet malazeze për shkak të veprave penale 'Vrasje e rëndë' dhe 'Mbajtje e paautorizuar të materieve plasëse', të Kodit Penal të Malit të Zi. Bashkëpunimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe organeve të pavarura të sundimit të ligjit si dhe përkushtimi për ta vendosur

sur para përgjegjësisë secilin person të dyshuar, e ka bërë Kosovën një vend primar në luftën kundër krimit ndërkombëtar dhe një vend të pasigurt për kriminelët", ka thënë Tahiri. Ai ka theksuar se në sajë të përkushtimit në luftën ndaj krimit transnacional, që nga shtatori i vitit 2017 deri më nëntor 2019 janë përmbyllur 165 ekstradime më shumë sesa kanë ndodhur për vite të tëra marrë së bashku.

## IPK-ja, pjesë e konferencës së mbikëqyrjes policore në Bullgari

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Me ftesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Bullgarisë, kryeshëfja ekzekutive e IPK-së, Miradije Kelmendi, po merr pjesë në konferencën e katërt të njësisë të kontrollit të brendshëm /mbikëqyrjes policore që po mbahet në Stara Zagora të Bullgarisë. Në këtë konferencë, e cila është organizuar nga NERCISU -

Network for Enhanced Regional Cooperation of Internal Security Units (Rrjeti për bashkëpunim të zgjeruar rajonal të njësisë të sigurisë së brendshme), janë duke marrë pjesë edhe përfaqësuesit homologë nga vendet e rajonit dhe më gjerë si Turqia, Greqia, Rumania, Mali i Zi, Maqedonia Veriore, Serbia etj.

Konferenca shërben edhe si

platformë e shkëmbimit të përvojave të njësiteve në fushën e kontrollit të brendshëm në njërin anë si dhe praktikave të luftimit të korrupsionit në shërbimet policore në anën tjetër. Delegacioni i IPK-së ka prezantuar përvojat e saj dhe praktikat në fushën e mbikëqyrjes policore dhe luftimit të korrupsionit në polici.





# Oda Amerikane prezanton potencialet ekonomike të Kosovës në shtetin amerikan të Minnesotas

SAINT PAUL, 5 NËNTOR (ER) - Me synim të promovimit të potencialeve për investime në Kosovë, leadershipi i Odës Ekonomike Amerikane ka zhvilluar një sërë takimesh me autoritetet ekonomike dhe tregtare, me odat lokale ekonomike, si dhe bizneset nga shteti amerikan i Minnesotas. Në kuadër të kësaj vizite, anëtarët e Bordit të Guvernatorëve

të Odës Amerikane janë pritur nga Departamenti Ekonomik i Minnesotas, Zyra Tregtare e Minnesotas, Oda Ekonomike e Qytetit të Saint Paulit, Oda Ekonomike e Shtetit të Minnesotas, por edhe nga kompani individuale, përfshirë edhe kompaninë e fuqishme inovative "3M".

Delegacioni i Odës Ekonomike Amerikane ka folur për të arrit-

urat e Kosovës përgjatë njëmbëdhjetë vjetëve si shtet si në aspektin ekonomik, po ashtu edhe në aspektin e stabilitetit të përgjithshëm, duke theksuar nevojën e investimeve amerikane jo vetëm në Kosovë, por në tërë rajonin.

Kosova është prezantuar si një shtet nga i cili kompanitë prodhuese amerikane të cilat do të vendoseshin në Zonën e

Veçantë Ekonomike Amerikane do të mund t'i eksportnin produktet e tyre lehtësi në tregun evropian dhe më gjerë në ato shtete me të cilat Kosova ka marrëveshje për tregti të lirë.

Në anën tjetër, Kosova mund të mësojë shumë nga shtetet amerikane siç është rasti me Minnesotan, e cila, duke promovuar një program lehtësir-

ash për investitorët, ka arritur të ketë një prani të madhe të kompanive nga lista "Fortune 500" e bizneseve më të fuqishme.

Oda Amerikane ka ftuar për vizitë në Kosovë delegacione tregtare nga shteti i Minnesotas, të cilat do të mund të njoftoheshin nga afër me potencialet ekonomike të shtetit më të ri evropian.



## OAK-u shpreh shqetësim për rritjen e tarifave nga bankat komerciale

EPOKA  
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kamata prej pesë përqindësh për kthimin e parave të imëta, tarifat e larta të bankave komerciale për deponimin e të hollave, numri i ulët i bankomatëve dhe numrit të degëve të bankave, provizionet e posave dhe mundësia kufizuar e deponimit të parave cash në ATM, ishin disa nga çështjet që u ngritën në takimin e përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti dhe zyrtarin Arben Mustafa.

Kryetari i bordit të OAK-së, Skënder Krasniqi, ka falënderuar guvernatorin për takimin, duke shprehur gatishmëri për informimin lidhur me problemet që po ballafaqohen bizneset me bankat komerciale në vend, shqetësime këto të cilat OAK-u i ka pranuar nga bizneset anëtare.

Çështja e përmendur në takimin e kaluar rreth tarifës prej 5-8 përqindësh për kthimin e parave të imëta në të letres është adresuar përsëri për shkak të kërkesës së madhe të bizneseve për uljen e kësaj tarife dhe si pasojë e mosmarrjes së ndonjë përgjigje nga ana e BQK-së për këtë kamatë.

Krasniqi ka theksuar se është shumë e rëndësishme që të krijohen politika të mira financiare në mënyrë që të përmirësohen kushtet e të bërit biznes në vend. "OAK-u vlerëson se problemet e lartcekura të bizneseve në raport me bankat komerciale dhe problemet e tjera të evidentuara të cilat do të përcillen me shkrim në BQK, jo vetëm se po shkaktojnë mosardhje të investitorëve të huaj, por po ndikojnë edhe në mosrritje të mirëqenies dhe mungesë të zhvillimit ekonomik", ka thënë Krasniqi.

Drejtoresha e Rrjetit të Shitësve me Pakicë, Yllka Metaj, ka thek-



suar disa nga problemet që ky rrjet ka evidentuar, e të cilat kanë të bëjnë me: unifikimin e posave e cila do të lehtësonte shumë punën e bizneseve që ajo përfaqëson, Swift fees për visa dhe master card si dhe përqindja e pagesës në POS-a të bankave të ndryshme, e cila shihet si një barrierë tjetër që duhet të hiqet. Gjithashtu, përfaqësuesi i biznesit ISP Broadcast, Qëndrim Kryeziu,

ka shprehur problemet që ai po ballafaqohet me bankat komerciale, e që kanë të bëjnë me kostot e deponimit të mjeteve, rritjen e kostove për shërbime, sigurinë gjatë deponimit në ATM si dhe kufizimin e shumës dhe përshkrimin për deponimet që realizohen nga bizneset në ATM.

Ndërkaq, guvernatori Fehmi Mehmeti ka theksuar se tashmë që një kohë po merren me kri-

jimin e tarifave të bankave që do të vendosen në rregullore për produktet bazike dhe që do të vlejë për të gjitha bankat komerciale si dhe kanë filluar punimin për unifikimin e POS-ave. Ai ka kërkuar që të gjitha bizneset t'i adresojnë problemet në divizionin e ankesave në Bankën Qendrore të Kosovës, për të cilat pastaj do të ndërmerren hapat e nevojshëm.



# BE-ja do t'i përkrahë ndërmarrjet dhe organizatat e shoqërisë civile me 3.5 milionë euro

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Kosova është ekonomi në zhvillim, me rritje mesatare të bruto prodhimit vendor (BPV) prej 4.2 përqindësh në pesë vjetët e fundit, që është ndër më të lartat në Ballkanin Perëndimor. Por, duke pasur parasysh rritjen e popullsisë prej 2 përqindësh çdo vit, përmirësime të tilla në rritjen për frymë banori në Kosovë janë të parëndësishme.

Popullsia e Kosovës përlogaritet në rreth 1.793,467 banorë, ku popullsia në moshë pune prej 1.202,982 përfaqëson rreth dy të tretat e popullsisë totale.

Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), edhe tani Kosova ka një nga

shkallët më të larta të papunësisë në rajon në 30.5 për qind dhe, gjithashtu, 63.5 për qind e grave në fuqinë punëtore janë të papunësuar.

Faktori gjinor është, gjithashtu, një tregues i rëndësishëm se gratë janë në pozitë të pafavorizuar, në krahasim me meshkujt, në të gjitha nivelet e arsimimit, pra kanë më shumë gjasa të bëhen apo të mbeten të papunësuar. Për më tepër, edhe personat me aftësi të kufizuara përballen me kufizime që ndikojnë dukshëm në statusin e tyre të punësimit dhe një përqindje e madhe e tyre janë të papunësuar. Pavarësisht prej faktit se 43 për qind e personave me aftësi të kufizuara (PAK) shfaqin interesim ose kanë potencialin t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre, sipas Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, shkalla e



punësimit të personave me aftësi të kufizuara (PAK) është 6,47 për qind.

Në reagim ndaj këtyre nevojave të menjëhershme për punësim, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka dizajnuar dhe lansuar skemën e granteve prej 3.5

milione eurosh, të titulluar "Përmirësimi i qasjes në tregun e punës për grupet e pafavorizuara përmes ndërmarrjeve sociale dhe masave aktive të tregut të punës". Kjo skemë e granteve synon të mbështesë masa aktive shtesë për tregun e punës, si

përkrahje e përshtatur sipas nevojave për aftësim, trajnim në vendin e punës, praktikë dhe vetëpunësim për grupet e pafavorizuara në Kosovë.

Gjithashtu, përmes kësaj mbështetjeje BE-ja synon ta përkrahë zhvillimin e ndërmarrjeve sociale si mundësi për krijimin e perspektivave për punë, sidomos për grupet më të cenueshme në tregun e punës, me që ndërmarrjet sociale u ndihmojnë interesave të komunitetit (objektivave sociale, të shoqërisë dhe mjedisore) dhe jo maksimizimit të përfitimeve.

Objektivat specifike të kësaj thirrjeje për propozime janë: Përkrahja për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale në Kosovë; Përkrahja për avancimin e punësimit të grupeve të pafavorizuara, kryesisht gratë dhe të rinjtë.

## KEDS Academy VII hap dyert për studentë dhe nxënës

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - KEDS Academy ka hapur dyert për gjeneratën e VII. Nga dita e martë deri më 15 nëntor, studentët e vitit të fundit të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, atij të Ndërtimitarisë si dhe nxënësit e shkollave të mesme teknike të klasave të 12-ta, mund të aplikojnë për t'u bërë pjesë e programit njëvjeçar të KEDS Akademisë.

Gjithsejtë do të pranohen 65 aplikantë, prej të cilëve 30 studentë dhe 35 nxënës.

Kriter për studentët është nota mesatare, njohja e gjuhës angleze dhe shkathtësitë komunikuese dhe ato të njohjes së teknologjisë informative.

Për nxënës është suksesi në mësim, shkathtësitë komunikuese dhe ato të teknologjisë informative, përderisa njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Pjesëtarët e Akademisë aftësohen profesionalisht si në aspektin teorik, po ashtu edhe në atë praktik për tregun e punës. Ata që e kalojnë me sukses programin njëvjeçar në fund pajisen me certifikata të njohura ndërkombë-



tarisht.

KEDS Akademia ofron një program që është komplet i financuar nga kompania, sjell për të ligjruar profesorë eminentë nga Universiteti Bogazici i Stambollit, që rangohet ndër universitetet

më prestigjioze të Botës. Ligjërues janë edhe menaxhmenti i KEDS-it, përderisa pjesa praktike bëhet në departamente të ndryshme të kompanisë.

Deri tash, në gjashtë gjeneratat e para të KEDS Akademisë janë

aftësuar dhe certifikuar 300 studentë dhe nxënës. Një pjesë e madhe e tyre janë punësuar në KEDS apo në kompanitë e tjera energjetike.

KEDS Akademia është vlerësuar edhe nga organizatat botërore

duke fituar deri tash shumë çmime në sektorin e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës në qendra të rëndësishme globale, si në Paris, Londër, Uashington e shumë të tjera.

## Largohet nga puna një inspektor tatimor, i dënuar për korrupsion

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se në pajtim me nenin 60, paragrafin 1, nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, ka nxjerrë vendim për shkëput-

jen e marrëdhënies së punës për inspektorin tatimor të dënuar për korrupsion. "Menaxhimet i lartë i ATK-së siguron opinionin publik se çdo informatë e dëshmuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare


si dhe rasteve korruptive do të dërgohet në organet kompetente për trajtim dhe ndaj të gjithëve që shpallen fajtorë për vepra penale, sikurse në rastin e lartpërmendur, do të ndërmerren masat e largimit nga marrëdhënia

e punës në institucionin tonë", është thënë në njoftimin e ATK-së. ATK-ja ka falënderuar qytetarët, mediat, Prokurorinë dhe Policinë e Kosovës për mbështetjen në luftimin e dukurive negative.





# DHUNËTARËT E HISTORISË



Rexhep QOSJA

Udhëheqja e Lidhjes Demokratike të Kosovës qe shumë vjet e dhunon historinë e Kosovës! Udhëheqja e LDK-së e dhunon historinë e Kosovës duke e falsifikuar historinë e saj. Meqenëse historia e Kosovës, e Kosovës si territor historik i Shqipërisë, është përbërës i historisë shqiptare në përgjithësi, kuptohet se udhëheqja e LDK-së po e dhunon historinë e popullit shqiptar!

Ky dhunim i historisë shqiptare ishte punë e kahershme e udhëheqjes së LDK-së, e përshtirë, e përthelluar, sidomos pas krijimit të UÇK-së dhe, si pasojë e krijimit e të luftës së saj, e komprometimit praktik e historik të politikës së LDK-së. Metodologjia me të cilën LDK e dhunon dhe e falsifikon historinë e Kosovës është metodologji tipike staliniste.

Udhëheqja e LDK-së pa ngurrim dhe në vijimësi i mohon disa nga veprimet dhe disa nga ngjarjet e dëshmuara me data kur kanë ndodhur e me vendin ku kanë ndodhur në të cilat tregohen dështimet e mjerimet e saj politike.

Udhëheqja e LDK-së pa ngurrim përdor anëtarë e zyrtarë të saj dhe gazetarë nga disa medie të kolonizuara prej saj për sulme ndaj atyre studiuesve e intelektualëve që i deklarojnë me gojë a me shkrime të dhënat për veprimet, qëndrimet, sjelljet, bëmat, ngjarjet në të cilat shihen ato dështime e mjerime të saja politike me pasoja kur më të pakta e kur të mëdha për gjendjen e përtashme e për ardhmërinë politike e kombëtare të Kosovës.

Shembull i sjelljes staliniste të udhëheqjes së LDK-së ndaj atyre që e kritikojnë, duke ua hequr maskat falsifikimeve e mashtrimeve të saj të historisë së vet dhe të historisë shqiptare në përgjithësi, është sjellja e një zyrtari të saj në ditën e ndarjes nga jeta të Adem Demaçit. Ky zyrtar i LDK-së nga një komunë e Kosovës në postimin e vet në profilin e vet të FB-ut, nuk e përmbajti urrejtjen e tij ndaj Adem Demaçit dhe duke e quajtur monstrum shprehu hapur gëzim të cilin e emetuan më pas disa medie elektronike pse, pse, pse më në fund "Përçarësi numër 2 i shqiptarëve ka ikur nga kjo botë! Pritet të ikë edhe Shpendkeqja që është përçarësi numër 1. Këta dy monstruma i bënë pikë e pesë shqiptarët"! Me postimin e tij u pajtuan dhe u

solidarizuan edhe dy zyrtarë të tjerë të lartë të LDK-së, njëri prej tyre deputet në Kuvendin e Kosovës.

Reagimet që kjo deklaratë makabre e zyrtarit të LDK-së shkaktoi në opinion, e detyruan udhëheqjen e LDK-së ta detyrojë deklaruesin që t'i kërkojë falje familjes së Adem Demaçit, por, natyrisht, jo edhe të urreyerit numër 1 të kësaj specie që me gjuhë të shtazërishtme të hienës politike dëshiron të mbrojë Kosovën me dhuratat që udhëheqja e tij ua çonte Millosheviqit e Millutinoviçit! E dinte Udhëheqja e LDK-së se kundër të urreyerit numër 1 do të organizojë fushata të reja, fushata të reja siç ishte kjo mbas botimit të shkrimit të tij për reagimet tona "gjithëkombëtare" kundër Komitetit Nobel, në të cilën ajo, udhëheqja e LDK-së, i përmbloodhi afër 50 anëtarë dhe rrogëtarë që i stolisën disa gazeta, disa televizione dhe shumë portale të rrjetit social me urrejtje, shpifje, gënjeshtër, denoncime partiake LDK-iste ndaj Rexhep Qosjes! Dhe, kjo fushatë e re e LDK-së, le të thuhet, e anëtarëve të vjetër më shumë se e atyre të brezit të ri të saj, e shtyri Rexhep Qosjen të shkruajë këtë skicë për politikën falimentuese të udhëheqjeve të deritashme të LDK-së!

1. Udhëheqja e LDK-së reagonte gjithmonë mosdurueshëm kur i thuhej me gojë a me shkrim se

programi i saj politik, i botuar së pari në gazetën e Beogradit Nasha Borba, mandej në revistën Alternativa të Shoqatës Migjeni të shqiptarëve në Slloveni, e, mandej edhe në ditarin Dëshmitar në kohë historike, vëllimi 6, të Rexhep Qosjes, ishte program për një autonomi të Kosovës më të rrëguar, më të varfër politikisht e juridikisht, se ç'ishte autonomia e vitit 1974. Për këtë arsye ajo e fsheh tani këtë program tre pash nën dhe!

2. Udhëheqja e LDK-së reagonte mosdurueshëm kur i thuhej me gojë a me shkrim se pas krijimit, në fund të vitit 1989, ajo e kishte regjistruar partinë e saj, e quajtur Lidhja Demokratike e Kosovës, ngjashëm me Lidhjen e Komunistëve të Kosovës, në Ministrinë e Drejtësisë së Serbisë në Beograd!

3. Udhëheqja e LDK-së reagonte e reagon dhe tani ashpër, me fjalë fyese ndaj autorëve të të dhënave që dëshmojnë se udhëheqja e saj e përparme, përmes kryetarit të saj, sa e sa herë i ka penguar studentët të çohen në demonstrata, duke u thënë se ashtu do të pengojnë zgjedhjet serbe në Serbi në përgjithësi.

4. Udhëheqja e LDK-së reagonte posaçërisht vrazhdë kur i thuhej se me politikën e saj, të vetëquajtur paqësore, e në të vërtetë nënshtruese, si parti opozitare e Serbisë, duke përmbushur të

gjitha obligimet "shtetërore" ndaj Serbisë, po e dobësonte, në të vërtetë po e shkatërronte lëvizjen kombëtare në krye me organizatën studentore për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

5. Udhëheqja e LDK-së reagonte shumë vrazhdë, kur i thuhej me gojë a me shkrim se në mbledhjen e saj, në objektin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, ku e kishte selinë ajo, ditën e vrasjes së një pjesëtari të lavdishëm të UÇK-së është deklaruar: sot është vrasë një mafi vrasja e të cilit i ka gëzuar serbët dhe shqiptarët! Kjo informatë u është thënë disa personave prej një anëtarit të Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së, që sot me disa anëtarë të familjes së vet e mjel PDK-në, e mandej është bërë publike prej Komisarit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së, Jirzhi Dintsbir.

6. Udhëheqja e LDK-së reagon vrazhdë, fyeshëm, kur shkruhet se prej anëtarëve të Kryesisë së saj, madje prej kryetarit të saj, Ushtria Çlirimtare e Kosovës është quajtur, kur dorë e zgjatur e Serbisë, kur grupe njerëzish të frustruar, kur organizatë terroriste, kurse, si shkruante gazeta Koha Ditore me 22.9.1998, Komisarit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së Jirzhi Dintsbir, i është thënë se UÇK" është turpi më i madh i popullit shqiptar!"

7. Udhëheqja e LDK-së reagon vrazhdë edhe kur i tregohet e botuar Marrëveshja që kryetari i

saj, me 28 prill 1999, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, e ka nënshkruar me kryetarin e atëhershëm të Serbisë, Millan Millutinoviç, me të cilën krijohet qeveria kuislinge e Kosovës. Ndërsa, Millan Millutinoviç në këtë Marrëveshje nënshkruhet si kryetar i Serbisë, kryetari i LDK-së, i shpallur dhe kryetar i Kosovës në "zgjedhjet" e vitit 1998 në gjendje lufte!!! nënshkruhet si kryetar i LDK-së. Është e qartë se nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje ishte akt tradhtie që kryetari i LDK-së po bënte jo vetëm ndaj Kosovës së shpallur e pavarur në mbledhjen e ish deputetëve të Kosovës në Kaçanik, po edhe ndaj kërkesës për Kosovën e lirë e të pavarur për të cilën po demonstroi, po burgoseshin e po vriteshin sa e sa studentë e të rinj të tjerë. E aktet e tilla, të tradhtisë, dihet si quhen, si gjykohen e si dënohen në politikën, në gjykatat e në historinë e popujve historikë, me dinjitet e me kulturë politike e shtetërore.

8. Udhëheqja e LDK-së reagon vrazhdë, fyeshëm, me fjalë banale kur dëgjon a lexon se në solemnitetin e nënshkrimit të asaj Marrëveshjeje kryetari i LDK-së dhe i Kosovës, i Kosovës autonomi, në të vërtetë koloni e Serbisë, do t'i dhurojë kryetarit të Serbisë, Millan Millutinoviç, dhurata të cilat, siç do të deklarohë ai në bisedë me gaze-

K0068909

Kryetari i Republikës së Serbisë Millan Millutinoviç dhe Dr. Ibrahim Rugova u morën vesh për këtë

## DEKLARATË TË PËRBASHKËT

1. Është e nevojshme që menjëherë të përsëriten dhe të intensifikohen bisedat ndërmjet Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe liderëve politikë të partive politike të shqiptarëve në Kosovë e Metohi për marrëveshje politike me të cilën Kosmetit i jepet vetëqeverisje e gjerë me respektimin e plotë të barazisë së të gjithë qytetarëve e të gjitha bashkësive kombëtare dhe të sovranitetit e të tërësisë territoriale të Serbisë e të Jugosllavisë. U konstatua se një qëndrim i këtillë është bazë për zgjidhje të drejtë dhe të përhershme të problemeve në Kosmet.

2. Të dy palët u pajtuan që bisedat të jenë të drejtpërdrejta, krahas pjesëmarrjes së barabartë të të gjitha bashkësive kombëtare që jetojnë në Kosovë e Metohi, si parakusht për t'u arritur zgjidhje të pranueshme për të gjithë që jetojnë në Kosovë e Metohi.

3. Në mbështetje të pajtimit të të dy palëve, në biseda, në cilësinë e mysafirit, mund të marrin pjesë përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare.

4. U arrit pajtimi për domosdonë e krijimit të shpejtë, në kushte të ndryshuara, të Këshillit të Përkohshëm Ekzekutiv të Kosovës e Metohisë, që do të kryejë funksionin e Qeverisë së përkohshme derisa të konstituohen organet në bazë të Aktit themelor mbi vetadministrimin në Kosovë e Metohi. Përbërja e Këshillit të Përkohshëm Ekzekutiv dhe organizimi i tij i brendshëm, në mënyrë të veçantë përcaktimi e dikasterëve të organeve të vetëqeverisjes, duhet të marrin parasysh problemet e tanishme në Kosovë e Metohi.

726

Dr. Ibrahim Rugova  
(nënshkrimi doravetë)

Millan Millutinoviç  
kryetar i Republikës së Serbisë

Në Prishtinë, 28 prill 1999

K0068909

Председник Републике Србије Милан Милутиновић и Др Ибрахим Ругова  
сагласили су се о следећој

## ЗАЈЕДНИЧКОЈ ИЗЈАВИ

1. Потребно је да се одмах обнове и интензивирају започети разговори између Владе Републике Србије и политичких лидера политичких партија Албанаца на Косову и Метохији о политичком споразуму, којим се Космету даје широка самоуправа, уз пуно поштовање равноправности свих грађана и свих националних заједница, суверенитета и територијалне целовитости Србије и Југославије. Констатовано је да овакав приступ представља основу за трајно и праведно решење проблема на Космету.
2. Обојстрано је закључено да разговори треба да буду директни, уз равноправно учешће свих националних заједница које живе на Косову и Метохији, што је предуслов да се постигну привативна решења за све који живе на Косову и Метохији. Директни разговори треба да буду потврда јачања међусобног поверења као битног услова за излазак из садашње ситуације.
3. На основу обојстране сагласности, разговорима, у сајству госта, могу да присуствују представници међународне заједнице.
4. Постигнута је сагласност о неопходности скорог формирања, у промененим условима, Привременог извршног већа Косова и Метохије, које би вршило функцију привремене владе до конституисања органа на бази Основног акта о самоуправи на Косову и Метохији. Састав Привременог извршног већа и његова унутрашња организација, посебно утврђивање нове ресурсне поделе органа управе, треба да узавања садашње проблеме на Косову и Метохији.

  
Др Ибрахим Ругова

  
Милан Милутиновић  
председник Републике Србије

У Приштини, 28. априла 1999.

727



tarët ditën kur po dorëzonte detyrën e kryetarit të Serbisë dhe po bëhej gati të udhëtonte për Hagë, për t'iu paraqitur Gjykatës Speciale Ndërkombëtare, do ta stolisnin gjatë Kabinetin e tij në Qeverinë e Serbisë!

9. Udhëheqja e LDK-së reagon vrazhdë, fyeshëm, kur i thuhet me gojë, në radio e televizione a me shkrim në gazeta se LDK-ja në radhët e saj kishte anëtarë e zyrtarë sekretë të cilët e informonin Sigurimin e Brendshëm Shtetëror të Serbisë në Kosovë për përbërjen dhe një varg çështjesh të tjera që kishin të bënin me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës!

10. Udhëheqja e LDK-së reagon ashpër, fyeshëm, kërcënueshëm kur i thuhet me gojë në radio e televizion a me shkrime në gazeta se kryetari i LDK-së, një kohë pas nënshkrimit të Marrëveshjes me Millan Millutinoviçin do të shkojë në Beograd, në takim me kryetarin e Serbisë, Slobodan Millosheviçin, të cilit do t'i çohen dhurata si Millan Millutinoviçit me rastin e nënshkrimit të asaj Marrëveshjeje. Çka është biseduar, çka ka ndodhur, çka është nënshkruar në atë takim do ta thonë një ditë arkivat e Serbisë, të cilat sot për sot nuk mund t'i shfrytëzojnë historianët shqiptarë. Tani për tani dihet vetëm se mbas atij takimi kryetari i LDK-së, i quajtur kryetar historik i Kosovës, koloni e Serbisë, i përcjellë prej njerëzve të Milloshiut do të shkojë në Aeroportin e Beogradit dhe prej tij do të fluturojë për Itali, ku pa u vonuar shumë, do të deklarojë se duhet të ndalen bombardimet e Serbisë prej Forcave të NATO-s! Dhe, do të shtojë: Millosheviçi është lideri i nderuar i Serbisë me të cilin duhet të bisedohet!

11. Se takimet dhe bisedat e disahershme të kryetarit të LDK-së dhe kryetarit të Kosovës koloni e Serbisë me Millutinoviçin, përmbanin një turp për Kosovën është thënë prej shumë veprimtarëve politikë shqiptarë në Kosovë e në Evropë. Një dëshmi për karakterin dhe "dinjitetin" e këtyre takimeve Millosheviç - Rugova do ta lërë njëri prej kundërshtarëve të Milloshiut, i cili shkruante edhe për disa gazeta evropiane, malazezi Stojan Ceroviç, i lindur në vitin 1949 e i vdekur në vitin 2005, në librin e tij Dalje nga historia. Aty, përpos të tjerash, ai do të shkruajë: në gjysmën e viteve të nëntëdhjeta një diplomat amerikan i propozon atij, Ceroviçit, të shkojë në Uashington dhe atje të vizitojë Arkivin që po krijohet. Kur Ceroviçi e pyet se çka do të ishte me interes për të në atë Arkiv ai, diplomati amerikan, do t'i përgjigjet: aty do të gesh, fjala vjen, edhe raportet e Ambasadës Amerikane në Beograd në të cilat tregohet se sa është i korruptuar kryetari i LDK-së. Nuk ka dyshim se cilësori i korruptuar flet jo vetëm për korrupsionin material po edhe për korrupsionin politik të kryetarit të LDK-së!

12. Udhëheqja e LDK-së reagon vrazhdë, tmerrueshëm, kërcënueshëm kur gojarisht a me shkrim i bëhen pyetje se çka ka bërë ajo gjatë një vargu vitesh me paratë e popullit, me atë tre përqindëshin, që mijë prej popullit? Ku shkuan gjithë ata miliona të mbledhur në Kosovë, në shtetet e Evropës, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e në shtetet e kontinentet e tjera ku jetonin e punonin shqiptarë, nuk u ble me to e me të tjera të mjela si ato prej popullit vetëm shtëpia e kryetarit të LDK-së! U blenë edhe të mira të tjera, edhe pasuri të tjera, edhe privilegje e lukse të tjera të drejtuesve të LDK-së dhe shfrytëzuesve të djersës së mërgimtarëve tanë të degdisur në Botë.

**PROGRAMI I LIDHJES  
DEMOKRATIKE TË KOSOVËS**

Miratuar në Kuvendin Themelues më 23 dhjetor 1989

Kriza e thellë shoqërore, ekonomike dhe politike, në të cilën gjendemi tash sa kohë para bashkësitë shumëkombëshe hapi shumë dilema që kanë të bëjnë me egzistencën e saj të mëtejshme. Në opion tashmë janë shumë programe dhe projekte që mëtojnë të fitojnë legjitimitet në Jugosllavi. Kjo larmi idesh, propozimesh e deni të programet me profile të qarta politike tregojnë me së miri se për fatin e Jugosllavisë janë të brengosur dhe të preokupuar të gjithë, dhe se, e ardhmja e saj mund të garantohet po që se për të angazhohen të gjitha subjektet e saj, pa iu rezervuar asnjë e drejtë që të flase apo të vendose në emër të të tjerëve. Pra, Jugosllavia, duhet kuptuar si interes i secilit, ngase ajo është themeluar me vullnetin e lirë të të gjithëve, edhe me vullnetin e popullatës së Kosovës dhe se për çdo rregullim të si të federatës është e drejtë imamente që të vendosin lirisht edhe qytetarët e Kosovës.

Fakti që kriza e thellë dhe e gjithanshme që po e rëndon vendin dhe që më fuqimisht e me pasojë më të rënda po shprehet në Kosovë, kërkon lirisht radikale në fushën ekonomike, shoqërore e politike, se ajo mund të përballohet e të tejkalohet vetëm me angazhimin dhe veprimin e të gjitha forcave subjektive e të potencialeve krijuese dhe se ky angazhim nuk është i mundur në kuadër të monizmit politik dhe të monopolitit një partiak, në të nënshkruant morerit iniciativën që të formojmë. Lidhjen Demokratike të Kosovës si shoqatë për veprim shoqëror-politik e kulturor të të gjithë atyre që miratojnë orientimet programore të Lidhjes Demokratike dhe intencat e saj.

1. Lidhja Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm LDK) angazhohet për reformat ekonomike e shoqërore që synojnë daljen sa më të shpejtë nga kriza dhe zhvillimin më të shpejtë ekonomik të vendit. Për këtë qëllim LDK angazhohet për ekonomi të tregut, forma të ndryshme të pronësisë, për treg modern dhe për përjashtimin e ndërhyrjes jokuompetente të politikës në çështjet ekonomike (nga orientimi i pa kriteri i investimeve deni të caktimi i kuadrit drejtues në ekonomi), gjë që kishite dhe ka pasojë të dëmshme.

Kosova, përkuadër potencialeve njerëzore dhe natyrore, është krahina ekonomikisht më e papapunë dhe me papunësi më të madhe. Prapambetja ekonomike dhe papunësia janë forma permanente të krizës. Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se pikënisht prapambetja ekonomike dhe papunësia janë problemet kryesore të Kosovës dhe përpiqen për përballimin dhe tejkalimin e tyre. LDK përpiqet për stimulimin e iniciativave dhe të angazhimetve investive, për racionalizimin dhe modernizimin e prodhimit, për rekonstrukcionet e orientime prodhuese dhe jo për falimentimet dhe shuarjet të munitarëve të organizatave ekonomike; angazhohet për të drejtën e barabartë të secilit në punë varësisht nga aftësitë, angazhohet kundër privilegjeve në këtë lëmi në baza regionale, kombëtare ose të tjera.

Lidhja Demokratike e Kosovës angazhohet për shfrytëzimin e të gjitha potencialeve dhe mundësitëve për zhvillimin ekonomik të Krahinës; angazhohet për politikë sociale, siç ndodh në të gjitha shtetet moderne dhe për solidaritet të të zhvilluarve ndaj të pazhvilluarve.

2. Lidhja Demokratike e Kosovës angazhohet për një Jugosllavi demokratike, federative, socialiste dhe për reformën e sistemit politik në këtë drejtim. LDK angazhohet për demokraci, që do të sigurojë barazinë e plotë juridike e politike të të gjithë qytetarëve, të individit, të dinjitetit dhe të pronës së tij, pavarësisht nga përkatësia kombëtare, gjuhore apo fetare; angazhohet për shtetin juridik, që respekton kushtetutën dhe ligjin e përjashton arbitraritetin politik dhe pushtetmbajtjen. Angazhohet për pluralizëm politik që shpreh strukturat dhe interesat e ndryshme e mundëson gatën e koncepcioneve dhe të opioneve politike të ndryshme dhe për sistemin shumëpartiak; angazhohet për mbrojtjen e plotë dhe zgënjimin e lirisë të njeriut e të qytetit, për të drejtën e mendimit dhe të

shprehjes së lirë, për lirinë e fjalës, të shtypit e të organizimit politik; angazhohet për gjyqet e pa varura dhe për përjashtimin e varësisë së individit, të ndërllojeve dhe të ndërllojeve të gjyqësorëve. Lidhja Demokratike e Kosovës angazhohet për zhvillimin e raporteve demokratike në federatë, duke e kuptuar atë si bashkësi të subjektëve të barabarta të republikave dhe të krahinave, si bashkësi të qytetarëve dhe të nacionalitetëve të barabarta. Pra, angazhohet për federatë moderne, e cila do të mundësojë barazinë e nacionalitetëve, të republikave dhe të krahinave, për sistemin parlamentar në bazë të së drejtës së votimit të lirë, të drejtëpërdrejtë e të përgjithshëm, për Kuvendin Federativ të përbërë nga Dhoma e Republikave dhe e Krahinave, si dhe nga Dhoma e Qytetarëve. Angazhohet për vendosjen me konsensus për të gjitha çështjet e rëndësishme të vendit. Lidhja Demokratike e Kosovës do të angazhohet për zgënjimin e kanaleve demokratike institucionale, në drejtim të nifimimit dhe të afirmimit të më tutshëm të individualitetit të Kosovës dhe të pozitës kushtetuese, duke e kuptuar Kosovën gjithëherë si bashkësi të qytetarëve dhe nacionalitetëve të barabarta. Lidhja Demokratike e Kosovës angazhohet për afirmimin e subjektivitetit shoqëror, politik e kulturor të shqiptarëve dhe për të drejtën e tyre që, varësisht nga mundësitë që u ofrojnë numri, përqendrimi e shkalla e zhvillimit, në marrëveshje me popujt me të cilët jetojnë bashkësisht, të shfrytëzojnë format e konstitimit politik e juridik që do të afirmojnë barazinë e tyre.

3. E vetëdijshme për faktin që bashkëpunimi, mirëkuptimi, miqësia dhe solidariteti i popujve janë rezultat dhe frytë më të rëndësishme të civilizimit, kurse gjëndjet dhe armiqësitë janë fatkeqësi e tyre e madhe, LDK do të angazhohet vendosmërisht për zhvillimin e miqësisë dhe të bashkëpunimit të gjithanshëm të të gjithë popujve në Kosovë, në Jugosllavi dhe në botë. Barazi e plotë përbën edhe parakushtin qenësor të miqësisë dhe të bashkëpunimit të popujve. Prandaj, LDK përpiqet për barazi të plotë kombëtare në Jugosllavi e në Kosovë. Ajo do të punojë për afirmimin e vetëdijes së Kosova është e gjithë atyre që jetojnë në të:

-se shqiptarët, malazezët, serbët, turqit dhe të tjerët historikisht dhe aktualisht e kanë Kosovën të tyre dhe bashkësisht duhet ta zhvillojnë dhe ta përparojnë;

-se jeta në miqësi është bazë e mirëqenies dhe e lumturisë së popujve;

-se shumësia e kulturave dhe traditave, e kuptuar drejt, është pasuri;

-se bashkëpunimi dhe miqësia e popujve janë të pamundshme pa njohjen, mirëkuptimin dhe respektimin e kulturave dhe të traditave të qenieve dhe të interesave të njeri-tjetrit.

Lidhja Demokratike e Kosovës do të luftojë kundër çdo qëndrimi ose përkrahjeje të pabarazisë. Ajo veçmas do të angazhohet:

-kundër çdo privilegji ose diskriminimi kombëtar;

-kundër konceptetë mbi popujt autoktonë e shtetformues dhe popujt të prezencës së rastësishme e marginale;

-kundër çdo shovinizmi dhe hegemonizmi;

-kundër manipulimeve nacionaliste e burokratike me çështjen kombëtare.

Lidhja Demokratike e Kosovës përpiqet për barazinë e plotë të nacionalitetëve në Jugosllavi. Ajo angazhohet për zhvillimin e gjithanshëm kulturor të të gjithëve, për arsimim të plotë në gjuhën amtare në të gjitha shkallët e shkollimit; për ruajtjen e pozitës dhe të dinjitetit moral e material të shkollës; për kulturimin e gjuhës amtare dhe barazinë e saj në komunikim publik dhe në administratë; angazhohet për kulturimin e lirë e të barabartë të traditave kulturore e historike, për përdorimin e simboleve kombëtare dhe të kremtimit me dinjtet të festave kombëtare, për të drejtën dhe mundësinë që çdo popull të shfrytëzojë rezultatet pozitive të krijimit të vet kulturor dhe shpirtërore ludo që krijohet. Në këtë drejtim duhen zhvilluar edhe me tute institucionet që merren me studimin dhe kulturimin e kulturës, të traditës dhe të shprehjes së lirë të individualitetit kombëtar të të gjithëve në Kosovë dhe Jugosllavi.

4. Lidhja Demokratike e Kosovës përpiqet për të vërtetën për Kosovën, duke luftuar kundër dezinformatave e shpifjeve, kundër përpjekjeve që çështjet e sotme të Kosovës të paraqiten e për të tilit vetëm me terma diskualifikuese, pa u parë ato në tërësinë dhe kompleksitetin e tyre. Ajo është kundër represioneve e nikonstruksioneve si zgjidhje të problemeve, është kundër imponimit të pseudoproblemeve për t'u mbyllur problemet e vërteta, është kundër gjendjeve dhe masave të jashtëzakonshme, kundër izolimeve e kundër proceseve politike si dhe angazhohet për lirinë e të burgosurve politikë. Angazhohet, pra, për dialog konstruktiv e mirëkuptim të ndërsjellë dhe kundër diskualifikimeve dhe etiketimeve të çdo mendimi ose kërkesë që ndryshon nga ajo zyrtare e një partie.

5. Lidhja Demokratike e Kosovës do të angazhohet për ruajtjen e mjedisit dhe të bujinave natyrore. Asnjë brez nuk ka të drejtë që pa nikoqirëllë t'i shfrytëzojë ato që duhet t'u takojnë brezave të tjerë.

Në Prishtinë, më 23 dhjetor 1989

kryetari para tij, i Serbisë, Millan Millutinoviç, me dhurata nga duart e kryetarit të LDK-së!

16. Nuk e quaj të nevojshme t'i komentoj reagimet e udhëheqjeve të LDK-së ndaj të dhënave që për politikën e saj dëgjohej a shkruhen prej historianëve a intelektualëve të Kosovës në Prishtinë, të Shqipërisë në Tiranë a kudo qoftë tjetër.

E quaj të nevojshme vetëm t'ia sjell në mendje kësaj udhëheqjeje dy të vërteta që në shtetet demokratike, me tradita shtetërore, kulturore e qytetëruese, janë ligje etike e juridike.

E vërteta e parë është kjo: kryetar kuvendi, kryeministër apo kryetar shteti nuk bëhesh për të bërë qejfe, për të pirë e për të ngrënë ushqime e pije sa më të shtrenjtave falas, për të bredhur nëpër botë zyrtarisht a jozyrtarisht, për t'u pasuruar duke keqpërdorur karriget politike, për t'u rrethuar me servilë e mendjepaktë, që bëjnë krejt çka u thuhet mirë e keq! Kryetar kuvendi, kryeministër e kryetar shteti, nuk bëhesh, pra, për të zhvatur shtetin. Jo. Kryetar kuvendi, kryeministër e sidomos kryetar shteti, bëhesh, siç ishte bërë kryetari i LDK-së kryetar i Kosovës koloni e, mandej, shtet protektorat, që, në rast se e kërkojnë punët tragjike historike, edhe për të dhënë jetën për atë shtet, për nderim e dinjitetin e popullit që përfaqëson. E jo, jo, jo për të nënshkruar Marrëveshje tradhtie siç është ajo që u nënshkrua prej kryetarit të LDK-së e të Kosovës me kryetarin e Serbisë, shtetit okupator të

Kosovës, Millan Millutinoviçin më 28 prill, 1999!

E vërteta e dytë është:

Krim nuk quhet vetëm vrasja e njeriut, po edhe vrasja e të vërtetës dhe e të drejtës.

Udhëheqja e LDK-së po vret të vërtetat dhe të drejtat që nuk i pëlqejnë, që nuk janë në interesin e saj, që e zbulojnë, e përfushin, e tregojnë politikën e saj në thelbin e saj: gjithnjë politikë e mjerë e, siç u pa më lart, në disa raste edhe politikë tradhtare.

Për fatin e historisë shqiptare, këto vrasje janë të përkohshme. Historinë e Kosovës, historinë shkencore të Kosovës, nuk do ta shkruajë LDK-ja po historianët. Historia e falsifikuar që LDK-ja e ka shkruar për veten e Kosovën do të ketë fatin e historive parti-ake e shtetërore që Stalini e Duçe kishin shkruar për partitë e tyre dhe për shtetet që kishin sunduar me dhunë: do të hidhet në plehun e historisë!

Historinë e Kosovës dhe të Shqipërisë së bashkuar nuk do ta shkruajnë partitë po historianët e Shqipërisë dhe të Kosovës së Bashkuar. Një shkruer i saj jam edhe unë jo vetëm me Ditarët e mi.

Por, para se të shkruhet kjo histori e Kosovës, pasi Kosova të bëhet shtet i së drejtës, shpresoj që të vërtetat dhe të drejtat të cilat do t'u shpëtojnë vrasjeve prej rrenave, shpifjeve e urrejtjeve të anëtarëve, të udhëheqësve të kryehershëm dhe të mëvonshëm të LDK-së dhe të rogetarëve të saj do t'i sjellin shumë të dhëna e dëshmi të reja arkivore e kujtimore asaj historie.



## Yovanovitch: U këshillova të shkruaja pozitivisht për Trumpin

UASHINGTON, 5 NËNTOR - Ish-ambasadorja amerikane në Ukrainë, Marie Yovanovitch, tha se një zyrtar i administratës së presidentit Trump i kishte thënë se duhet ta shprehte në "Twitter" mbështetjen për presidentin Donald Trump, nëse donte të mbante punën, sipas tekstit të zbardhur të dëshmisë së saj për para ligjvënësve, që u bë publik të hënën.

Diplomatja Yovanovitch tha se ambasadori amerikan në Bashkimin Evropian, Gordon Sondland, e kishte këshilluar që ta tregonte hapur mbështetjen për Trumpin, pasi ajo ishte akuzuar

nga media e djathtë se ishte armiqësore ndaj presidentit.

Teksti i zbardhur i dëshmisë së Yovanovitch para ligjvënësve në tetor u bë publik të hënën nga tri komisione të Dhomës së Përfaqësuesve që po merren me hetimin e për procesin e shkarkimit të presidentit Trump. Republikanët e kanë kritikuar hetimin e drejtuar nga demokratët, pasi nuk i kanë bërë intervistat publikisht. Sipas tekstit, ish-ambasadorja Yovanovitch u tha ligjvënësve se kishte dëgjuar akuzat në media, sipas të cilave, ajo i kishte thënë stafit të saj në ambasadë t'i injoronte urdhrat e

presidentit pasi ai do të shkarkohej. "Ajo akuzë është e reme. Nuk ia kam thënë kurrë një gjë të tillë as kolegëve të ambasadës, as ndonjë njeriu tjetër", tha ajo.

Yovanovitch, një diplomate karriere u shkarkua në maj, disa muaj para afatit. Presidenti Trump e kishte përshkruar atë si "një lajm të keq" në telefonatën e tij me presidentin ukrainas, Volodymyr Zelenskiy. Ajo u tha ligjvënësve se ishte ndjerë e tronditur dhe e kërcënuar, kur kishte marrë vesh se presidenti Donald Trump kishte folur për të gjatë telefonatës.

"Ishashumë e shqetësuar", tha ajo.



Yovanovitch tha se kishte mësuar vitin e kaluar se avokati personal i Trumpit, Rudy Giuliani, kishte kontakte me ish-kryeprokurorin

ukrainas, Yuri Lutsenko, "dhe se ata kishin pasur plane dhe se do ta ndërmermin veprime, përfshirë kundër saj".

# Pompeo dhe mundësia e kandidimit të tij për postin e senatorit

Edhe pse ka spekulime se sekretari Pompeo mund të japë dorëheqje dhe të kandidojë për Senatën amerikane, disa vëzhgues të politikës thonë se roli i tij në bllokimin e ndihmës ushtarake amerikane për Ukrainën dhe procesi i hetimit të presidentit mund të kenë ndikim në perspektivën e tij politike



UASHINGTON, 5 NËNTOR - Udhëtimet e shpeshta zyrtare të sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, në shtetin e tij Kansas, kanë nxitur spekulime se ai mund të japë dorëheqje dhe të kandidojë për Senatën amerikane. Por disa vëzhgues të politikës thonë se roli i Pompeo në bllokimin e ndihmës ushtarake amerikane për Ukrainën dhe procesi i hetimit të presidentit mund të kenë ndikim në perspektivën e tij politike.

Sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, ka zhvilluar tri vizita zyrtare në shtetin e tij Kansas këtë vit. Vizitat e tij kanë tërhequr shumë vëmendjen e medias, përfshi këtu edhe shefin e kanalit televiziv "Fox News", Rupert Murdoch, i cili me shaka e prezantoi Pompeo javën e shkuar në Nju Jork si njeriu me shumë tituj. "Përfaqësuesi Pompeo, drejtori Pompeo, sekretari

Pompeo, senator Pompeo, president Pompeo".

Gjatë vizitës së fundit, Pompeo u pyet nga një gazetar nëse procesi i hetimit të presidentit ka ndikuar tek ambicjet e tij politike. "Nuk ka ndryshime. Besoj se i jam përgjigjur kësaj pyetjeje qindra herë. Misioni im nis çdo mëngjes kur zgjohem, është tejet i qartë. Detyra jonë në Departamentin e Shtetit është që ta mbajmë të sigurt popullin amerikan, ta zbatojmë diplomacinë amerikane dhe të sigurohemi që tregjet amerikane janë të hapura për produktet e Kansasit në mbarë botën", tha ai.

Pompeo ka përsëritur vazhdimisht se ai do të shërbejë si sekretar Shteti për aq kohë sa dëshiron presidenti Trump. Por ekspertët thonë se së paku ai do ta marrë në konsideratë kandidimin për Senat. "Ai do të argumentojë se kjo nuk po e pengon që t'i kryejë detyrat si

sekretar Shteti. Por është një dyzim i çuditshëm kur kemi një sekretar Shteti që duket se po e studion terrenin, ndoshta për një mundësi kandidimi për Senatën", tha Burdette Loomis nga Universiteti Kansas.

Hetimi lidhur me bllokimin e ndihmës ushtarake amerikane nga administrata e presidentit

Trump mund të ketë ndikim negativ në perspektivën e Pompeo, thotë për "Zërin e Amerikës" profesoresha Burdette Loomis. "në javët dhe muajt e fundit ka rënë shkëlqimi i Pompeo. Nuk është e qartë se cili ka qenë roli i tij në Ukrainë. Sigurisht që nga dita në ditë, mungesa e moralit në

Departamentin e Shtetit po bëhet më e dukshme", tha Loomis.

Ndërsa roli i tij në hetimet për Ukrainën po vëzhgohet me kujdes, Pompeo tha për median lokale se njerëzit në Kansas nuk janë të përqendruar ndaj asaj që ai e quajti "zhurmë" në Uashington.

## Steinmeieri e falënderon Gorbachevin për ribashkimin e Gjermanisë

BERLIN, 5 NËNTOR - Presidenti i Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, e falënderoi ish-udhëheqësin sovjetik, Mikhail Gorbachev, për rolin e tij në ribashkimin e Gjermanisë në vitin 1990. "Ribashkimi paqësor i Gjermanisë dhe fundi i ndarjes së Evropës nuk do të ishin të mundshme pa vendimet e guximshme dhe njerëzore që ju personalisht i morët në atë kohë",

shkroi Steinmeier në letrën dërguar Gorbachevit.

Letra vjen tri dekada pas rënies së Murit të Berlinit, gjë që ka çuar në ribashkimin e Gjermanisë brenda një viti, përkatësisht më 3 tetor 1990. Ajo, po ashtu, vjen në kohën e marrëdhënieve të tensionuara midis Rusisë dhe Perëndimit. "Ajo që më dhemb më shumë është gjendja e marrëdhënieve gjermane-ruse dhe

evropiane-ruse", tha Steinmeieri.

Në një intervistë për BBC-në, të publikuar më 4 nëntor, Gorbachev tha se parimi i tij në atë kohë ka qenë "të mos ketë gjakderdhje". "Nuk mund ta lejonim një gjë të tillë për një çështje kaq të madhe për Gjermaninë, për ne, për Evropën, për tërë botën", tha Gorbachev, 88 vjeç.







## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



# “SENSORËT” POETIKË

BERAT ARMAGEDONI

Këtë përzgjedhje me poezi e kam hartuar nga këta tre libra të poetit Lulzim Tafa: *I kam edhe dy fjalë* (2012), *Shtini n'dhe këto fjalë* (2015), *Flirt* (2019). Nga secili prej këtyre librave kam vjelë nga njëzet e pesë poezi. Sipas bindjes dhe shijes time, kam zgjedhur dhe mbledhur më të mirat. Por, vlerësimin mund ta jepni ju pasi, pos kësaj përzgjedhjeje, t'i lexoni të gjithë librat e tij. Nëse e kam harruar ndonjë poezi tjetër që ka vlerë më shumë se këto, në faqen e dytë e keni e-mailin e shtëpisë botuese në të cilën mund të jepni kritika, sugjerime dhe vlerësime. Të njëjtat mund t'i publikoni edhe në media.

Po ashtu, kam publikuar, në vend të prologut, edhe një poezi të autorit që s'është botuar në asnjë libër të tij.

Autori i këtij libri këtë lloj të shkrimit letrar e pati filluar sa ishte nxënës në shkollën fillore. Ka dëshmi (faksimile revistash) të publikimit të vjershave të para të tij në atë kohë. Por, lidhje më të fortë fizike dhe më të ndjeshme me poezinë paraqiti kur, sa ishte student, e botoi librin e parë (më 1993) me poezi dhe la në dorëshkrim edhe një tre libra të tjerë, prej treqind poezish, të cilët nuk i shpëtuan luftës e për të cilët, siç do të shohim në disa poezi, autori ndien për ta si për një njeri që i mungon shumë.


Lulzim Tafa, paralelisht me poezinë dhe letërsinë, profesion, ndërkohë edhe pasion, kishte edhe studimet në fushën e drejtësisë, në të cilën ka vite që ka doktoruar. Megjithatë, reagimet, mendimet, sidomos ato që lidhen me drejtësinë e munguar në vendin tonë, i shpreh nëpërmjet poezisë, e cila, më shumë se profesioni i tij i parë (drejtësia), e ka bërë të njohur në disa vende të botës për shkak të eksportimit të dhembjes individuale dhe kolektive që ka në poezinë e tij, pastaj edhe duke marrë çmime për vlera letrare që kanë veprat e tij. Me një fjalë, duke ndërkombëtarizuar topikën dhe temat e motivet e popullit të Kosovës, sidomos ato në kohë të paraluftës e të luftës, për poezinë e Tafës është shfaqur interesimi i fqinjëve për krijimtarinë e tij poetike, për përkthimin e poezive të tij në gjuhën angleze, gjermane, italiane, serbe, kroate, boshnjake, rumune, frënge, suedeze, arabe, maqedonase, slovene, hungareze etj. Po kaq interesim për poezinë e tij, përpos përkthyesve dhe botuesve, ka shfaqur edhe

kritika dhe revistat e profilizuara për letërsi, të cilat i kanë përkthyer dhe botuar poezi së bashku me shënime nga jeta.

Sapo të bëjmë një kërkim bibliografik për krijimtarinë e tij na shfaqen mbi pesëdhjetë recensione për librat e tij që janë shkruar nga akademikë, profesorë, studiues, kritikë, përkthyes, botues, lexues nga vendi ynë dhe nga vende të huaja, të cilët kanë vënë re se, *që nga momenti i botimit të librit të tij të parë me poezi, Lulzim Tafa ka demaskuar me mjeshtëri pushtimin dhe gjencidimin serb mbi popullin e Kosovës, dhunën e ushtruar mbi kulturën, fenë dhe letërsinë kosovare* (Tase Tase). Në këtë rast s'bëhet fjalë vetëm për art të angazhuar edhe pse, dorën në zemër, poetët edhe në këtë mënyrë kanë dhënë kontribut për çështjen kombëtare sa që në shumë raste kanë pësuar fizikisht nga pushtuesit. Në këtë kontekst, mund të themi se poezia e Tafës është një deklaratë në vargje për të ndodhurat në kohë të para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës në Kosovë. Është një poezi përplot figura stilistike, të cilat, në vargjet e thyera, përsëritin dëshirat dhe ndodhitë edhe të autorit, edhe të popullit të tij.

Sa mbaj mend, poezinë e Tafës kam filluar ta lexoj në vitin 2005 sa kam qenë student letërsie. Nuk e kishim të obliguar në fakultet por, duke u shoqëruar me miq të tij, profesorë të mitë, Agim Vincën, Sali Bashotën, Ibrahim Berishën, Milazim Krasniqin, Basri Çapriqin (ndjesë pastel) e ndonjë tjetër, duke u diskutuar ndër takimet tona poezia e tij, një ditë, për ta thënë edhe unë ndonjë fjalë a vetëm një fjalë për të, kërkova libër të tij në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Aty s'i gjeta të gjithë librat që i kishte botuar deri në vitin 2005, por i gjeta dy prej të katërve, *Gjaku nuk bëhet ujë* (1993) dhe poemën *Planeti Babiloni* (1997). Ndërkaq, *Metaforë e pikëlluar* (1995) dhe *Vdekja çon fjalë* (1998) nuk janë as sot në fondin e Bibliotekës Kombëtare “Pjetër Bogdani” dhe as nuk kam bërë përpjekje tjetër që t'i gjej.

Poezia e tij, në takimin e parë, më pëlqeu. Dallonte nga ajo e miqve të tij: e Vincës, e Bashotës, e Berishës, e Krasniqit, e Çapriqit... Ishte e tjetërllajt. Ani pse Tafa me ta ishte miq, unë s'gjeja miqësi në poezitë e tyre. Veçanti, po. Individualitet, po. Gjetje tematike e stilistike, po.



Lulzim Tafa (1970) është nga Lipjani. Studimet themelore dhe pasuniversitare i ka përfunduar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, kurse të doktoratës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës. Është një ndër poetët më të njohur dhe më të përkthyer të letërsisë shqipe në botë. Ka fituar shumë çmime prestigjioze ndërkombëtare të poezisë. Është anëtar i rregullt i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve, anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve në Paris të Francës si dhe bartë disa tituj nderi në akademi dhe universitete prestigjioze në botë. Është profesor universitar dhe rektor i Kolegjit AAB. Jeton në Prishtinë.

Kjo përzgjedhje dhe përmbledhje poezish është fryt i luftës së Kosovës, i përjetimeve të ngjarjeve të ndryshme nga autori, i reagimeve të tij të matura e të pamatura ndaj institucioneve dhe udhëheqësve të tyre. Është, po ashtu, fryt i raportit të tij me disa të dashura, të cilat, meqë s'i njohim, mund të jenë jo persona, por personazhe, sa për ta shpërfaqur autori i tyre talentin edhe për poezi erotike, pa i heshtur fjalët edhe kur “uji vlohet”, edhe kur “sensorët” e tij janë fort të ndjeshëm.

Sh. B. Armagedoni

4,99 €



Takimin e dytë, me poezinë e Tafës, e pata në vitin 2012, kur e botoi librin *I kam edhe dy fjalë*, për të cilin, menjëherë pas përfundimit, shkrova një recension të gjatë, pasi që stilin monoton të disa poetëve ai e nëpërkëmbi me një titull të thjeshtë metaforik të kombinuar me litotë, *I kam edhe dy fjalë*, dy fjalë të gjata të cilat përfunduan në njëqind faqe tekst, me ligjërim të shkujdesur, pa marrë parasysh çfarë thotë standardi i gjuhës për fjalën e saktë, pa marrë parasysh çfarë thotë etika për fjalën dhe sjelljen, pa ia varë as stilit të pararendësve, temave e motiveve të tyre. Rebelizmi i këtij poeti nis me trajtimin e të ashtuquajturave tema tabu dhe me theksimin e shprehjeve, po ashtu tabu, të cilat e dallojnë nga brezi i vet dhe i mëparshmi, po edhe nga i mëvonshmi.

Duke lexuar këtë libër do të shohim se poeti Lulzim Tafa artin e së mundshmes, politikën, e bën art të letërsisë nëpërmjet figurave poetike të cilat i shpërndan pak në tituj të poezive, më shumë në vargje. Nëse politika në majë të gjuhës e ka ironinë, edhe në poezitë e këtij libri më e pranishme se akëcila figurë tjetër është ironia, në disa satira, e cila përdorim më të madh ka në poezitë shkruar në dhjetëvjetëshin e fundit, të cilat, edhe pse nuk kanë ndonjë shënim të vitit në fund të faqes, nga përdorimi i

fjalëve të tyre e personazheve të stilizuara e të satirizuara, duken se janë krijuar në dhjetëvjetëshin e fundit. Kjo rimarrje e temës të së kaluarës paradigmatozohet, pasi njerëzit që i kanë kalëruar kuajt deri dje, sot i ngasin xhipat, e këta poeti Tafa nuk ka dashur t'i lë pas shpinës, madje as vetëm në kujtesën e kompjuterit e në të vetën, as t'i falë për të bërë e të zhbërë, por të na bëjë me dije me saktësi se kush ishin deri dje. Përqeshja që ua bënë është edhe ironike, edhe humoristike. Ani pse humor i zi, është i këndshëm.

Më tutje, në poezitë e këtij libri ka poezi me temë të luftës nga Kosova, me temë kombëtare, me motive sociale, erotike, filozofike, përkushtuese, të fëmijërisë. Temën e parë, të luftës së fundit në Kosovë, e hasim në të tria ndarjet që kam bërë, në të cilat, nëpërmjet figurës së paradoksit, vdekja identifikohet me njeriun, me vrasjet e përditshme të shqiptarëve nga serbët. Ligjërimi i këtyre temave të mëdha më tepër është filozofik sesa emocional dhe shprehësiv. Shquhet në to egërsia e pushtuesve, në të njëjtën kohë ikja e pafuqja për reagim e popullit shqiptar: *Mo' Zot e liga / e çohen e vijnë / i presim me gjoks / qafën ua shtrijmë*. Dhe derisa ata vijnë, Tafa nis ta endë në letër ironinë për ta: *Me përkrahje / kombëtare e /*

*qiellore. / Masakra ishte e ligjshme / mbështetur në nenin 1 për vrasjen e të gjithë shqiptarëve. / Ishin vrasësit më humanë / lavdi / vranë pa dallim / burra / gra / fëmijë... E në këtë kohë lufte, kur të gjitha çmimet e ushqimeve ngritën, çmimi i jetës bie: Në Kosovë atë ditë / u shtrenjtua buka / vaji / mielli / sall jetës i ra / çmimi / vdekje / kishte me bollëk. Madje shpërthen edhe ironia më therëse, se këtu “sundon” ligji, se këtu nuk shkelen të drejtat / dhe liritë e njeriut / këtu shkelen vetëm kokat!*

Sikurse disa politikanë që kujtohen për përdorim të theksuar të satirës e të ironisë gjatë fjalimeve të tyre, edhe disa poetë mbahen mend për të tillë në shkrime poetike. Një prej tyre është poeti Tafa, i cili, për t'i satirizuar disa njerëz të sotëm të politikës e veprimet e tyre, për të cilët është krijuar shprehja se me brekë të grisura kanë hyrë në politikë, ose që ditën janë deputetë e natën biznesmenë, ka marrë dy personazhe nga mitologjia popullore (nga besimet popullore) shqiptare, konkretisht Mujin dhe Halilin, të cilëve ua mbështjellë satirën për trupin dhe për karakterin, pasi ata iu kanë zbritur kuajve, por u kanë hipur xhipave. Dmth., kemi personazhe mitike të cilët kontekstualizohen e paradigmatozohen me personat që janë në pushtet (në pozitë), që s'lenë gjë pa bërë për interesa



# TË LULZIM TAFËS

personale dhe familjare. Derisa poeti i sheh këta muja e halila postmodernë të hipur në xhipa nuk ka se si t'i përshëndesë ndryshe përpos ta përdorë ligjërimin e shkujdesur ndaj tyre: t'i shajë me "nanë", në të njëjtën kohë të thurë edhe *Epitaf* për vdekjen e poezisë: ... *ç'sëmundje muzave / u sollli liria / nanën bre ia qifsha / si vdiq poezia*, se pa të e kupton se është vështirë t'i qajë hallet e veta dhe të popullit e t'i fshehtë emrat e atyre bosëve sikurse veptoi me dy personazhet mitike. Për ta mbyllur gjithë këtë fushë të zezë dhe për t'u dhënë fund këtyre paradokseve, vijmë ditët e mira për autorin, poezitë e

dashurisë, të cilat prapë lënë mundësinë e shtrimit të pikëpyetjeve, se mos autori i tyre do t'i thotë edhe dy fjalë të tjera në ndonjë libër tjetër, po kaq pa perde e pa pullë të kuqe sikurse i ka shkruar disa prej poezive erotike dhe epshore. Kjo mbetet të shihet.

Vështruar territorin poetik të disa poetëve të tjerë të Kosovës, ato çfarë e ofrojnë poezinë e këtij poeti me, ta zëmë, poezinë e Çapriqit, Bashotës, Podrimjes e ndonjë tjetri, janë vetëm disa fjalë të ngjashme që as ky nuk mund t'i shmangë nga poezitë e veta sikurse janë: nata, tmerri, terri, liria, robëria, gjarpri, të cilat të tre poetët i kanë ndër fjalët më të përdorura në poezitë e veta dhe të cilat kanë funksione poetike, pasi asnjëra nuk është figurë e qejfit të poetit, por e dëshpërimit të tij, e kohës së keqe e të ligë, e vrasjeve, e

maltretimeve dhe e shpërdorimit të pushtetit nga njerëz që moralin e kanë në nivelin e vetëdijes njerëzore. Dmth., prapë jeta, edhe në këtë "liri të mutit" siç thoshte Basri Çapriqi në një varg vite më parë sa qe gjallë, është e zezë edhe te Tafa, veçse në poezinë e tij ka njëfarë shprese që haset sidomos në poezitë me temë dhe me motive nga dashuria dhe nga seksi që nuk heziton ta bëjë aty ku i vjen rasti e që nuk kursen as jetën për një bukuri të rrallë të vajzës që quhet Hanë e që i shëmbëllen trupit qiellor, Hënës.

Po qe se shtegtojmë më tutje dhe kërkojmë ngjashmëri tematike dhe ideore, poezitë e Tafës në rrafshin kombëtar mund t'i vëmë në raport krahasimi me poezitë e Xhevdet Bajrajt, ndërsa në rrafshin ballkanik me poezitë e Izet

Sarajliqit e të Marko Veshoviqit. Në poezitë e këtyre katër poetëve ka portrete, përshkrime, kujtime, njoftime, rrëfime për karaktere njerëzish, skena komike dhe tragjike, skica dhe skeçe. Ka në to simbol, groteskë, antitezë, krahasim, metaforë, hiperbolë, litotë, inversion, paradoks, alegori, paralelizëm figurativ, personifikim. Gjuhë, thujtë të njëjtë. Ka kujtime të mira dhe të këqija. Ankth dhe stres. Krime dhe dëshmi. Skena të dhunës dhe dhunime. Barbarë dhe zuzarë. Të gjallë dhe të vdekur. Prezantim të krimeve e të dëmeve të mëdha serbe bërë në Kosovë dhe Bosnjë Hercegovinë. Domethënë, poezia e këtyre katër poetëve ka, përpos letrar, edhe dimension historik, të historisë më të re të Kosovës e të Bosnjë Hercegovinës. Pa dyshim se, duke shkruar për popullin dhe

kombin e vet, këta katër poetë kanë ndërkombëtarizuar çështjen e popullit dhe të kombit të vet. Zëri i protestës së tyre, veçmas i Tafës dhe i Bajrajt, është kundër atyre njerëzve të pushtetit që pronën shtetërore e përdorin për nevoja personale dhe familjare, që pasurohen shpejt e shpejt, pa i dhënë llogari askujt. Kjo përzgjedhje dhe përmbledhje poezish është fryt i luftës së Kosovës, i përjetimeve të ngjarjeve të ndryshme nga autori, i reagimeve të tij të matura e të pamatura ndaj institucioneve dhe udhëheqësve të tyre. Është, po ashtu, fryt i raportit të tij me disa të dashura, të cilat, meqë s'i njohim, mund të jenë jo persona, por personazhe, sa për ta shpërfaqur autori talentin edhe për poezi erotike, pa i heshtur fjalët edhe kur i "vlohet uji", edhe kur "sensorët" e tij reagojnë fort ndjeshëm.

## BORAÇKA<sup>1</sup>

*Në vitin 1944  
Mileva  
fshatarja serbe  
konvojit të partizanëve  
ia dha  
një palë çorape  
të leshata*

*Dyzet vjet e gëzoi  
"Boraçkën"  
pensionin e luftës së lavdishme të LNÇ-së  
nga shteti  
i leshit*

<sup>1</sup> Shpërblim financiar, pension, për luftëtarët e luftës (anti)fashiste në Jugosllavi.

## HERONJTË E LNÇ-së

*Më nuk ju sjellin lule te varri  
Shokët ju kanë vdekur moti  
Tani ne kemi heronj të tjerë  
Ju keni vdekur kot  
Siç vdesin të gjithë heronjtë  
Por lufta e katërt botërore  
Do të bëhet shpejt  
Të gjithë do të vdesim  
Varret do të na pashiten  
Vetëm heronjtë do të mbesin  
Për t'u vlarë mes vete*

## ASFALTI MBI ESHTRA

(Fëmijëve të pagjetur të luftës në Kosovë)

*Batajnica  
Rashka  
Rudnica  
Asfalti si qefin  
Mbi eshtrat e butë të fëmijëve  
Megjithatë  
Autoritetet atje  
E kanë një të mirë  
Janë trima  
Hiq nuk i tuten Zotit*

## LETËR BUJAR TAFËS

*Sapo u zgjova nga një trishtim  
Ëndërr e rëndë dimri*

*Gjumë arushe  
Luftë konfuze*

*Mjegull Ballkanit i ra  
Ti e di si bëhet lufta  
Komandanti më caktoi roje  
Në një kamp robërisht*

*Një gruajë shtatzënë i rashë grusht n'bark  
Ia poshtova fëmijën  
Një të dyshuar për spiu sapo e mbyta dru  
Djalin e mitur ia vrava plumb  
Se komandanti tha:  
Rrajën e fëlliqtë me zhbi*

*Por ti mos u trishto se  
Komandanti ka ide  
Nëse janë të pafajshëm  
I shpallim dëshmorë, i bëjmë heronj  
Heronjtë na duhen*

*Eh po ta kishe parë një ushtar armik  
Të plagosur, të zënë rob  
Si më lutej deri në përgjërim  
Më thoshte se më ka zot*

*E unë për një moment  
U bëra zot ose vetja m'u duk  
Ta kishe parë si qeshnin rojet  
Qeshnin me lot nga lutjet e tij  
Është mjegull, po mundohem ende ta kuptoj  
Ushtar i kujt isha, ushtar i kujt jam*

*Po unë nuk e di si m'i qorroi Zoti sytë*

*Po tani më kanë zënë ethet  
Më vlojnë djersët e  
Mbulue më ka zjarrmia  
As vetë s'e di a është e vërtetë  
A m'ka rrokë empatia*

Sarajevë, 2001



LULZIM TAFÄ

## SVETLLANA DHE LUFTA

*Kur përfundoi së numëruari  
Shtatëdhjetë e shtatë mijë veteranët e luftës  
Ali Podrimja  
Plasi e tha  
Merreni këtë liri  
E n'rrotë t'samës  
Atë nanë mashtruesve*

*Mos u bëj fëmijë bre  
I thashë  
E me besue  
Se pasha të madhin  
Burrat rrejnë  
Kur flasin për luftë  
Dhe për seks*

*Po nuk më besove mua  
Lexoje Svetllana Aleksieviqin  
Dhe e sheh  
Sa kurva u dha gjij  
Luftëtarëve*



E jashtëzakonshme

## Një burrë në Indi vdiq duke tentuar t'i hajë 50 vezë

Një ngjarje jo e zakonshme ka ndodhur në Indi. Një burrë ka vdekur duke u përpjekur që t'i hajë 50 vezë. S. Y. 42-vjeçar kishte shkuar në tregun e Bibiganjit, me një mik për t'i ngrënë vezët. Të dy miqtë vendosën ta pranonin sfidën, duke ngrënë 50 vezë, për të fituar rreth 25 euro. 42-vjeçari e pranoi bastin. Yadav arriti



të hajë 41 të tilla, para se të rrezohej papritmas dhe të binte pa vetëdije. Ai u dërgua në spital, ku vdiq vetëm disa orë më vonë, shkruan "Daily Mail".

FOTO E DITES



Pemët e mbuluara me dëborë rrethojnë një kasolle në Valea Rea në malet e Rumanisë. /AFP/

E rrallë

## Gruaja kapet me rreth 71 mijë euro ar në këpucë

Një grua ruse u arrestua nga autoritetet doganore të Rusisë për transportim të paligjshëm të shufrave të arit në Kinë. Gruaja e re po shëtiste në mënyrë të panatyrshme derisa kalonte nëpër dogana në një pikë kontrolli në kufirin ruso-kinez në qytetin Zabaykalski. Pasi i nënshtroi kontrollit me detektor metalik, ajo



dorëzoi vullnetarisht tetë shufra ar në total 1,863 gram (rreth 71 000 euro), të cilat i kishte fshehur në thembra të këpucëve me shirit ngjites.

## BARSOLETA E DITËS



- O bir, çka po punon?
- Vallahi që sa e përfundova Fakultetin e Ekonomisë.
- Mirë shumë, paske shpëtuar, më në fund!
- E tash, nëse s'priton, hajde nimomë t'i çoj skelet në Fakultetin e Mjekësisë!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

## ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.  
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

## TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.  
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

## MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.  
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

## ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.



### DASHI

Sot jeni nostalgjik dhe po mendoni veç për dashurinë. Një ndjenjë e mirë që ju bën mjaft të përkushtuar ndaj njerëzve.



### DEMI

Megjithëse në fundjavë keni pasur mjaft surpriza, ende nuk ka përfunduar efekti i tyre. Do të vazhdoni të merreni me to edhe sot.



### BINJAKËT

Gjithkush që mbush ditën tuaj sot do të merret me punët e veta personale duke ju lënë të qetë të mbyllni gjëra që ju ka kaluar afati.



### GAFORRJA

Jeni i gatshëm ta jepni kontributin tuaj për të ndryshuar disa mendësi në familjen tuaj që janë disi të prapambetura. Do të kërkon mbështetje.



### LUANI

Jeni goxha të ngarkuar në punë sot dhe nuk do të mund të bëni dot asgjë pa miratimin e një kolegut tuaj. Në debat e sipër do t'i tejkaloni pak limitet.



### VIRGJËRËSHA

Dita sot do të fillojë shumë vullshëm dhe ju nuk do të keni kohë të merrni frymë nga impenjimet e shumta.



### PESHORJA

Me miqtë dhe të afërmit koha kalon shkëlqyeshëm, por sapo afrohet dikush i panjohur në orbitën tuaj bëheni mjaft protektive.



### AKREPI

Po mbani ekuilibër të brendshëm me ata persona që e shikoni që kanë gjithmonë diçka për të thënë kundër jush. Nuk do të arrijnë t'ju prishin ditën.



### SHIGJETARI

Financat tuaja paraqiten shumë mirë këtë periudhë dhe gjithçka ka të bëjë me kontrata dhe marrëveshja do të jetë në favorin tuaj.



### BRICJAPI

Hëna në shenjë ju ndihmon sot të mos afektoheni shumë nga nostalgjia dhe nga probleme të vogla që mund t'ju prishin punë.



### UJORI

Sot jeni të pushuar nga dashuria dhe këtë herë e keni lëshuar totalisht veten ta përjetoni pasionin dhe dëshirën me sy mbyllur.




### PESHQIT

Një shef skrupoloz ose një i afërm i bezdisshëm sot s'po ju lënë të qetë. Në çdo moment do të jepni informacione se çfarë jeni duke bërë.



## Eminemi për pak vdiq nga mbidoza e drogës, shpëtohet nga Elton Johni



**R**eperi i famshëm Eminem gati vdiq nga mbidoza para se të ndihmohej nga Elton Johni. Fituesi 15 herë i çmimit Grammy, me emrin e vërtetë Marshall Mathers, u dërgua në spital pranë vdekjes në vitin 2007 pasi konsumoi ekuivalentin e

katër qeseve të heroinës. Sipas biografisë së fundit të Anthony Bozza: "Not Afraid: The Evolution of Eminem", reperi u përpoq dy herë që t'ia dilte mbanë vetë për të hequr dorë nga droga, por më pas kërkoi ndihmën e Elton Johnit.

## Cardi B thotë se akoma nuk ka gjetur asnjë dado të besueshme për vajzën e saj



**R**eperja e njohur, Cardi B, ka treguar për adhuruesit e vet në "Instagram", se ajo dhe nëna e saj kujdesen për vajzën e saj, Kulture. Kështu një adhurues i tha se ajo duhet

të marrë një kujdestare për vajzën. Cardi ia ktheu se ajo ende nuk i beson askujt që të kujdeset për fëmijën e saj, duke shtuar se është në kërkim të një personi të duhur dhe të besueshëm.



## Ava Max dhe Loredana, dy shqiptaret që u vlerësuan me çmim në MTV Ema

**S**uksesi evropian i "Sweet but Psycho" u kurorëzua për Ava Max me çmimin "Best Push" në MTV Europe Music Awards 2019. Këngëtarja me origjinë shqiptare dhe e lindur në ShBA arriti ta mposhtë konkurrencën e Billie Eilish, H.E.R., Mabel dhe Rosalia, duke marrë një çmim të rëndësishëm për artistët e rinj në eventin më të rëndësishëm

të muzikës në Evropë. Ava ishte edhe një performuese në skenën e Seviljes, ku elektrizoi publikun me hitet "Torn" dhe "Sweet but Psycho". Loredana ishte artistja tjetër shqiptare që u vlerësua në MTV Ema. Ajo u shpall këngëtarja më e mirë zvicerane për vitin 2019, ndërkohë që në të njëjtën kategori ishte edhe shqiptarja tjetër Ilira.

## Ciara dëshiron të ketë më shumë fëmijë



**C**iara dhe Russell Wilson duan ta zgjerojnë familjen e tyre. "Nëse e pyesni Russellin, ne po flasim për tetë foshnja", ka thënë ajo për "Extra". "Patjetër që pres të kemi më shumë fëmijë. Kemi kohë për

këtë", është përgjigjur në pyetjen e këtij mediumi. Çifti tashmë janë prindër të vajzës Sienna, dyvjeçare dhe Future, djali i Ciara me reperin Future. Ciara dhe Wilson festuan përvjetorin e tyre të tretë të martesës në korrik.



# “Pietà” shqiptare

**Nga: Harallamb FANDI**

Në rrugëtimin e fotografisë shqiptare dhe sidomos në fushën e studimeve për të, do të vinte dita kur bilanci do të merrte vlera pozitive. Është e qartë se jo çdo gjë ka shkuar “vaj” dhe, si nga fotografët ashtu edhe nga studiuesit, që ndonjëse janë shtuar janë ende të paktë, ka zëra që me të drejtë kërkojnë më shumë. Ka veprimtari, ka dhe përpjekje për t’i bërë ato më të larmishme, po gjithsesi nuk janë të mjaftueshme. E, kur flitet për libra, që shkruhen posaçërisht për fotografinë, i pari, për të mos thënë i vetmi, del në pah studiuesi dhe fotografi Qerim Vrioni. Pas tre librave: “Fotografia një grusht diell” (2005), “150 vjet fotografi shqiptare” (2009) dhe “Fjalori i fotografisë” (2013), që kurorëzojnë vazhden e më shumë se 100 artikujve të tij mbi fotografinë shqiptare dhe botërore, doli në dritë edhe një libër tjetër, me mjaft vlerë: “Pikëllim në një foto të vjetër” (2018), që unë do ta perifrantoja “Gëzim për një libër të ri”. Është kështu, se libri i ri ve në dukje karakteristikën themelore të veprimtarisë së tij të shpërfaqur në shumicën e artikujve: skrupulozitetin e

pasionuar ( theksoj dhe rezultativ) të kërkimit të vlerave tona fotografike, të humbura në kohë të turbullta, me apo dhe pa qëllim. Është një karakteristikë kjo, që hedh boll dritë mbi profilin e studiuesit si dhe mbi punën e pandërprerë të tij në këtë fushë. Duke përmendur seriozitetin e vazhdueshëm të studiuesit nuk kam parasysh vetëm kërkimet këmbëgulëse të bëra për burime të dhënash të shumta (mbi 30 botime e rreth 50 foto), shumë prej të cilave zbulohen për herë të parë. Kjo natyrisht që është e rëndësishme, por pasioni aftësia me të cilin është bërë një punë e tillë, i shpërfaqur thuajse në pjesën më të madhe të tekstit të shkruar e bën librin sa tërheqës aq dhe emocionues. Autori ia ka nisur punës për t’i kushtuar një libër të tërë një fotoje, vetëm pasi është bindur që me të do të arrijë të përcjelli emocione të shumta dhe do të zgjojë edhe te lexuesi të tjera mendime dhe emocione pozitive. Gjithsesi, bukuria dhe origjinaliteti i librit vihen edhe më tepër në dukje nga zbulimi e argumentimi logjik i veshur me pasion ( të përmbajtur, natyrisht, sepse shkenca kështu e do ) i një fotografie simbol të “Pietà”-së në thesarin e fotografisë shqiptare: “Pikëllim

në një foto të vjetër” e Kolë Macës, e cila mbart pa mëdyshje një cilësim të tillë. Simbolin e “Pietà”-së, bota e njeh më së shumti prej kryeveprës skulpturore të Mikelanxhelo Buonarotit. Vetë Mikelanxheloja i është drejtuar disa herë temës për të cilën bëhet fjalë, po kryevepra e mermertë në Bazilikën e San Pietros në Romë është një nga monumentet më të ndritura të tij dhe të krejt Rilindjes Evropiane. Modeli i saj, i ngulitur në mendjet dhe zemrat e gjithë artistëve, është studiuar gjatë qindra vjetëve dhe studiohet e ndikon akoma edhe sot në krijimtarinë e tyre. Nuk janë të paktë ata që me mënyrën e vet, po thellësisht të ndikuar nga gjeniu, kanë relizuar një “Pietà” që, kur ka dalë e suksesshme, ka shtuar edhe krenarinë e vendit ku ka lindur. Kjo ka ndodhur edhe me “Mona Liza”-n e Leonardo da Vinçit: nuk ka një, po ka disa “Mona Liza”, në disa vend të botës, madje të rikrijuara edhe nga piktorë gjenialë të artit modern, pavarësisht se madhështia e artit që mbartin kryeveprat e gjenive të Rilindjes është e papërsëritshme. Kur kalon nëpër mend çka u tha mësipër, duket se guxohet shumë për ta pagëzuar foton tonë me sim-


bolin që përmendëm, por ajo vjen thjesht e vetvetiu në vendin e saj të merituar. Autori i librit të bën të kujtohesh e, më pas, të bindesh për këtë, duke të orientuar drejt për ta pranuar si të tillë foton që në vështrimin e parë. Ndiesia që lind nga goditja prej shikimit të veprës te njerëzit, e veçanërisht te artistët e arteve pamore, është emocionuese, sepse pamja të kujton monumentalitetin e ngjashëm me atë të “Pietà”-së. Themi të ngjashëm, sepse figura e vajzës, ndryshe nga Madona e Mikelanxhelos, nuk qëndron vertikalisht, (gjë që është theksuar dhe në libër), po paksa e përkulur anash. Kjo e afron kuptimin e fjalës “Pietà” jo thjesht me fjalën “Mëshirë”. Te fotoja e Kolë Macës kuptimi i saj vjen si shprehje e dhimbjes tronditëse si dhe e pjesëmarrjes dhe e solidaritetit për atë po vuan, apo ka vuajtur në çastet e vdekjes. Këtë kuptim kultura botërore e njeh kështu që në botën e antikitetit, kur njerëzit për hallet e vuajtjet e tyre u drejtoheshin perëndive të ndryshme. Si shëmbull tipik përkushtimi dhe pjesëmarrjeje ( i afërt me atë të vajzës te fotoja e librit ) sillet gjithandej episodi nga vepra “Eneide”, ku gjatë luftës së Trojës heroi,

duke iu bindur Perëndive, ngarkon mbi shpatulla djalin dhe babanë e vet për t’i shpëtuar, duke vënë në plan të dytë problemet personale. Gjithsesi, ky kuptim mbetet i afërt me atë të mëshirës kristiane, veti që e ka tërësisht në dorë Zoti dhe që te vepra e Mikelanxhelos e shohim më së miri. Pavarësisht se madhështia e artit që mbartin kryeveprat është e papërsëritshme, yhemi me bindje se fotoja për të cilën flitet, konsiderohet me të drejtë në faqet e librit si “Pietà”-ja shqiptare. Autori i librit të bën të kujtohesh e, më pas, ta pranosh këtë, duke të orientuar drejtë dhe me argumente të shumta. I duhej “skanerizimi” i plotë, por edhe interpretimi shumëplansh i fotos së Kolë Macës për t’u vendosur atë në vendin që i takonte. Përmasat e kësaj ngjarjeje kërkonin një punë e trajtim dinjitoz, i cili rezultoi me librin që na erdhi në duar. Qerim Vrioni e kuptoi, gjeti kohën e duhur dhe punoi duke realizuar një vepër të vyer. Pas leximit të parë, kudo ku ta hapësh, edhe “rastësisht”, vepra të bën të lexosh akoma, qoftë dhe pak rreshta të tjerë sepse, siç thamë, ka brenda tyre pasionin, cilësi që për një libër ka po atë vlerë që ka dhe drita në fotografi./Telegrafi/





# Erotika e Janis Ricos



## Nga: Eleana ZHAKO

Një poet në fillim të të shtatëdhjetave, me një profil të skalitur nga një skulptor i panjohur i Greqisë së lashtë, me një mjekër gjysmë të hirtë, që ia thekson më tepër konturet e fytyrës së tij paksa të gjatë, me një cigare të përhershme në gishtërinjtë e tij, dhe që pjesën më të madhe të jetës ia kushtoi bindjeve komuniste dhe poezisë, ka një emër të njohur tashmë në gjithë botën: Janis Ricos.

Janis Ricos (1909-1990), nuk është aspak i panjohur për lexuesin shqiptar. Një pjesë e madhe e veprave të tij poetike, janë sjellë në gjuhën shqipe gjatë një periudhe të rëndësishme kohore, gati pa ndërprerje, me pikënisje librin "Mëhallat e botës" përkthyer nga Spiro Çomora më 1961.

### Ligjëratë mishtore

*Sa e bukur je. Më tremb bukuria jote. Kam uri. Kam etje për ty.*

*Të lutem: fshihu, bëhu e padukshme për çdo sy, e dukshme vetëm për timin sy.*

*Mbulohu nga flokët deri tek thonjtë e këmbëve me një vel të errët, të tejdukshëm,*

*Bel me pak preka nga dihatjet e argjendta të hënave pranverore.*

*Poret e tua shqiptojnë zanore, joshje që deh ndër bashkëtingëllore.*

*Nyjëtohen fjalë të fshehta. Shpërthime trëndafilash nga akti i dashurisë.*

*Beli yt zmadhohet, shkëlqen mbi qytetin e errur dhe baret me drita të venitura,*

*Mbi hamëtoret e detarëve.*

*Prozhektorë të gjelbër ndriçojnë farmacinë e natës.*

*Një rruzull i qelqtë sillet me të shpejtë duke treguar vendet e botës.*

*Të dehurit i merren këmbët nga një furtunë që fillon prej frymëmarrjes së vet.*

*Mos ik. Mos ik. Je kaq e lëndëshme, kaq e pakapshme.*

*Një dem i gurtë kërcen nga ballina, në barin e thatë.*

*Një grua lakuriqe ngjitet nëpër shkallën e drunjtë duke mbajtur një legen me ujë të nxehtë.*

*Avulli ia fsheh fytyrën.*

*Lart në ajër, një helikopter gjurmues bombardon në vende të papërcaktuara.*

*Ruaju. Ty të kërkojnë. Fshihu më thellë në duart e mia.*

*Pushi i batanijes së kuqe që na mbulon zmadhohet e zmadhohet.*

*Batanija bëhet arushë shtatzënë.*

*Dashurohemi pafundësisht nën arushën e kuqe,*

*Matanë kohës, matanë vdekjes, në një bashkim të vetëm, të përbotshëm.*

*Sa e bukur je. Bukuria jote më tremb.*

*Kam uri. Kam etje për ty. Dhe të lutem: fshihu.*

Ajo çka e bën të dashur poezinë e Ricosit për përkthyesit shqiptarë, është fqinjësia me Greqinë, fryma e majtë e poezive, larmia e tematikave të tij, lirizmi mallëngjyes dhe bashkërenditja krahas poetëve më të njohur botërorë.

Ricosi është ndër poetët grekë më të përkthyer dhe bashkë më dy nobelistët grekë, Odhiseas Elitis dhe Jorgos Seferis, përbën poetin e tretë grek i cili ishte në prag të Nobelit, por që për shkak të frymës së theksuar politike të poezisë së tij, mbetet "nobelisti i panominuar". Por, porsia poetët, Pablo Neruda (1953), Bertolt Brecht (1954), Luis Aragon (1957), Kostas Varnalis (1959) dhe piktori Pablo Picasso (1962), Ricosi do marrë në vitin 1977 "Çmimin Ndërkombëtar të Paqes Lenin", i cili ishte çmimi më i madhor i Bashkimit Sovjetik dhe ekuivalenti i Nobelit atë kohë.

Në vëllimin poetik, që i prezantohet lexuesit shqiptar nga Shtëpia Botuese "Dituria", me titullin "Erotika", poezia e tij i largohet frymës së theksuar politike, që karakterizon krijimtarinë e tij të viteve më të hershme, dhe i kushtohet Erosit, Imerodit, dashurisë mishtore, mallit për të dashurën, gjumit dashuror pas dashurisë.

Në fund të të gjashtëdhjetave të tij, gati dhjetë vite para vdekjes së tij, Ricosi do i falet Erosit me përdëlimin e një besimtari të përbetuar. Kërkon të sfidojë nocionin e kohës,

këtëj Polifemi gllabëritës, përmes verbimit të tij me shigjetën e dashurisë. Dashuria për poetin nuk ndalet as në gjumë. Porsi lumi, ajo rrjedh vazhdimisht dhe merr me vete gjithë pemët e gjithë zogjtë.

*Gjumë dashuror pas dashurisë. çarçafë të djesitur që varen nga shtrati përtokë. Dëgjoj nëpër gjumë lumin e fortë. Rrjedh ngadalë. Trungje të mëdha pemësh rrëshqasin në të. Në degët e tyre një mijë zogj udhëtojnë pa lëvizur me një këngë të zgjatur uji e gëthesh, që ndërpritet nga yjet. [...]*

Erotika, përbëhet nga tre pjesë, të cilat pavarësisht ngjashmërisë, dallojnë nga njëra – tjetra për nga stili, vargu dhe veçanësia. Pjesa e parë, e cila titullohet "Suitë minore në të kuqe maxhore", përmban 44 poezi të shkurtra, të cilat nuk janë të ndara në strofa dhe vihet re mungesa e shenjave të pikësimit. Poezia për Ricosin është një akt i pafundmë dashuror, ku fjalët përflaken, porsia lëkura e burrit dhe e gruas kur bëjnë dashuri, është kazma dhe lopata mbi mermer, kokriza e rërës ngjitur në trupin e të dashurës, qiell i kuq i mpiksuar, filxhani i porcelantë ku pasqyrohet lakuriqësia e saj, rrënjë të kapërthyer, gjithë universi, i mbrujtur me spermë, bajgë e lule limonësh. Pjesa e dytë "Trup lakuriq", është një poemë erotike vargësh të shkurtra, ku poeti mbyllet në trupin e së dashurës, fle e zgjohet brenda saj, në qendër të vargut ndodhet vetëm ajo dhe krejt natyra, trëndafil që lartësohet i vetmuar, ylberi, pylli i praruar, druvarët,

zogjtë, deti i Monemvasias, vendlindjes së poetit, fiqtë e egër mishtorë, figura të lashta mitologjike, Odiseja, Penelopa, Imerodi, ngjizin imazhin e muzës së tij, që ndodhet larg: Dy muaj që s'u pamë. Një shekull e nëntë sekonda. Ndërsa, pjesa e tretë, "Fjalë mishtore", janë poezi që ngjasojnë më tepër me proza të vogla poetike, për nga struktura e vargjeve. Edashura e poetit është një Diotimë mishtore, e kundërta e Diotimës platonike të lashtësisë, e cila përmbledh në trupin e saj gjithë trupat, që ai preku, vështroi, mori, ëndërroi; është një prostitutë – rioshe, që prishet, pa çarë kryet për paratë e klientëve mbi komodinë; një vajzë, që qëndron poshtë lulemollëve dhe petalet futen mes gjinjve të saj; një vajzë me përparësë të bardhë, që mbledh të vrarët e zhveshur.

*Mishra të çarë,*

*Gjak nuk është gjaku i 27 ditëve të tua;*

*por edhe ai më zbramps, më pengon, më tundon.*

*Gjaku është bërë që të rrjedhë shpengueshëm nëpër vena;*

*që ta dëgjosh përgjatë natës zemër me zemër, si muzika që vjen poshtë dyshemesë sonë, ku një tjetër çift me muzikë po përgatit më thellë dashurinë e tij.*

Erotika, është kuintesenca e krijimtarisë erotike më të rëndësishme të shkrimtarit, është grahma e tij e fundit për t'u përballur me vdekjen. /Top Channel/



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Dy derbi në Superligë

Xhiroja e 13-të e IPKO Superligës në futboll sjell sot (e mërkurë) dy ndeshje derbi. Nga ora 13:00, lideri i elitës, Ballkani, e pret skuadrën e Llapit e më pas, nga ora 18:00, në stadiumin "Fadil Vokrri" takohen Prishtina dhe Feronikeli. Dy ndeshjet e fundit për këtë xhiro zhvillohen sot (e enjte)

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 5 NËNTOR** - Elita e futbollit të Kosovës ka filluar të bëhet shumë interesante, kurse sot (e mërkurë) zhvillohen katër ndeshje të javës së trembëdhjetë, e që dy prej tyre janë superderbi. Ballkani, që është edhe lider aktual, e pret skuadrën e Llapit, me synim që ta vazhdojë serinë e rezultateve pozitive. Sulmuesi Jetmir Topalli ka thënë për gazetë se fitorja e fundjavës së shkuar ndaj "Nikli" është një motiv për ndeshjet e radhës, por që nuk ka parashikuar epilogun e derbit të sotëm. "Fitorja ndaj Feronikelit na ndihmon dhe motivon edhe më shumë për ndeshjet që kanë mbetur në sezonin vjeshtor, përfshirë edhe derbin e radhës ndaj Llapit. Ne do të hyjmë në fushë të përgatitur maksimalisht dhe do të angazhohemi që t'i përmbushim detyrat e trajnerit Ismet Munishi, pastaj të shohim se çfarë do të ndodhë", ka thënë Topalli. Për këtë ndeshje foli edhe kapiteni i Llapit, Mentor Zhdrella, i cili bën me dije se skuadra nga Podujeva do të ishte e kënaqur edhe me një barazim. "Do të jetë ndeshje e vështirë. Ballkani është ekip që duhet respektuar, madje është edhe në formë të mirë. Ne do të shkojmë për rezultat pozitiv, por do të jemi të kënaqur edhe me një barazim", ka thënë Zhdrella.

Diferenca në mes të këtyre dy skuadrave është gjashtë pikë. Derbi i dytë i kësaj xhiroje zhvillohet nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". Prishtina ka pësuar humbje në dy përballjet e fundit nga "Nikli", por portieri Visar Bekaj është optimist se kësaj radhe fitore do të shënojë Prishtina. "Shpresoj shumë se bashkëlojtarët e fazës së sulmit ta gjejnë golin kundër një kundërshtari të fortë siç është Feronikeli. Është fakt që 'Nikli' na ka mposhtur në dy duelet e fundit, por para saj ne kishim nëntë ndeshje pa u mposhtur ndaj tij. Me gjithë respektin maksimal si ekip i



mirë dhe kampion aktual, ka ardhur koha që ne tani ta mposhtim dhe ta vazhdojmë rrugën drejt kreut të tabelës", ka thënë Bekaj për faqen zyrtare të klubit kryeqytetas. Gazeta ka provuar të marrë prononcim edhe nga futbollistët e Feronikelit për ndeshjen ndaj Prishtinës, por ata nuk kanë qenë të gatshëm të flasin, për faktin se klubi ka marrë vendim që ata mos të deklarohen për media nëpërmjet telefonit apo postës elektronike. Prishtina aktualisht pozicionohet në vendin e katërt me 24 pikë, kurse Feronikeli është në vendin e gjashtë me 19 pikë. Sot në Skenderaj takohen Drenica-Trepça '89, kurse në Gjilan takohen Drita-Dukagjini.

## IPKO SUPERLIGA

**Të mërkurën takohen:**  
13:00 Ballkani - Llapi  
13:00 Drenica - Trepça '89  
13:00 Drita - Dukagjini  
18:00 Prishtina - Feronikeli

**Të enjten takohen:**  
13:00 Ferizaj - Flamurtari  
13:00 Vushtrria - Gjilani

## LIGA E PARË

**Të mërkurën takohen:**  
Vllaznia - Drenasi  
Arbëria - Trepça  
KEK-u - Ramiz Sadiku  
Malisheva - 2 Korriku  
Vëllaznimi - Istogu  
Dardana - Ulpiana  
Besa - Liria

**Të enjten takohen:**  
Vitia - Onix

## SHKURT

### Më 12 nëntor dalin në shitje biletat për ndeshjen Kosovë - Angli

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do t'i zhvillojë dy ndeshjet tejet me rëndësi në muajin nëntor. Fillimisht më 14 nëntor Kosova do të udhëtojë në Çeki për ta zhvilluar ndeshjen me kombëtaren çeke, ndërsa tri ditë më vonë, "dardanët", në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, do ta presin Anglinë.

Arianit Ahmeti, zëvendëssekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës për "KosovaPress" ka pohuar se më 12 nëntor do të dalin në shitje biletat për ndeshjen kundër "Tre Luanëve". "Biletat për ndeshjen kundër Anglisë do të dalin më 12 nëntor. 5% e stadiumit, saktësisht 750 bileta do të jenë për mysafirët, aq edhe sa u takojnë në bazë të rregullave", ka thënë Ahmeti. Ndeshja në mes të Kosovës dhe Anglisë zhvillohet më 17 nëntor me fillim nga ora 18:00.

### Përforcohen KB Peja dhe Ponte Prizreni

KB Peja ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me Arbër Berishën. 22-vjeçari, i lindur në Prizren dhe i gjatë 203 cm, në dy sezonet e fundit ishte pjesë e ekipit të njohur turk Gaziantep. Ai, po ashtu, ishte edhe pjesë e ekipeve turke si Karesi Spor dhe Bandirma Kirmizi. "Arbëri ishte edhe pjesë e kombëtares turke U18, në U18 Euro Championship A, ku ekipi turk e zuri vendin e tretë. Arbëri, së bashku me rikthimin e Drilonit nga lëndimi, do të na kthejë seriozisht në luftën për titull", thuhet në njoftimin e skuadrës së Pejës. Ndërsa KB Ponte Prizreni ka paraqitur për regjistrim lojtarin ndërkombëtar Nichols Ty Charles nga USA. Lojtari i lartpërmendur mund të regjistrohet në Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe të paraqitet për skuadrën prizrenase pas plotësimit të kriterëve në bazë të Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve në FBK.

### Shorti i Kupës në futboll

Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës është hedhur shorti për rrethin e parë të Kupës së Kosovës, ku janë bërë të ditura çiftet e ndeshjeve të para për këtë edicion në Kupën e Kosovës. Përveç skuadrave të Superligës, në këtë garë marrin pjesë edhe skuadrat e Ligës së Dytë dhe Ligës së Tretë, ku vetëm shtatë prej tyre kanë konfirmuar pjesëmarrjen ndërsa klubet e tjera nuk kanë mundur për shkak të financave. Kupën e Kosovës në edicionin e kaluar e fitoi Feronikeli i cili mposhti në finale Trepçën '89. Çiftet e plota në rrethin e parë janë: FC A&N-KF Vëllazëria, KF Minatori-FC Sharri, FC Dardanët-KF Behari. Fushë-Kosova pa lojë kalon rrethin e parë.

## Sot Lipjani - Trepça, nesër derbi Peja - Rahoveci

**PEJË, 5 NËNTOR** - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e nëntë e Superligës së Kosovës në basketboll. Sfidat kryesore është ajo ndërmjet Pejës dhe Rahovecit, që zhvillohet të enjten në palestrën "Karagaçi". "Vreshtarët" janë liderë të Superligës me gjashtë fitore

dhe një humbje, kurse pejanët kanë katër fitore dhe tri humbje. Fitorja e fundit e pejanëve ishte në sekondat e fundit ndaj Yllit të dielën.

Peja - Rahoveci takohen për herë të parë në Superligë, kurse në këtë edicion ishin ballafaquar

edhe në Ligën Ballkanike, ku kishin triumfuar pejanët. Sfidat tjetër që zhvillohet të enjten është ndërmjet Feronikelit dhe Bashkimit. Dy skuadrat janë në formë. Feronikeli ka tri fitore dhe katër humbje, kurse Bashkimi ka pesë fitore dhe dy humbje.

Skuadra nga Drenasi ka pasur ngritje të formës në xhirot e fundit, kurse prizrenasit së fundi arritën ta mposhtin Sigal Prishtinën.

Sot (e mërkurë) zhvillohet sfida Lipjani - Trepça. Lipjanasit në shtatë ndeshje kanë pësuar

shtatë humbje dhe nuk dinë për fitore në këtë edicion, derisa mitrovicasit në shtatë përballje kanë vetëm një fitore dhe gjashtë humbje. Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli zhvillohet në një termin tjetër për shkak se prishtinasit luajnë në FIBA Europe Cup.



## Prishtina dhe Ventspils synojnë ta kalojnë grupin

**PRISHTINË, 5 NËNTOR** - Kampionia e Kosovës në basketboll, Sigal Prishtina, sot (e mërkurë) nga ora 18:00 do të përballet me Ventspils në Letoni. Prishtina ka një fitore

dhe një humbje në këtë edicion në grupet e FIBA Europe Cup, kurse Ventspils ka dy fitore në dy ndeshje të zhvilluara në këtë edicion. "Bardhekaltrit", të udhëhequr

nga Dardan Berisha, kanë treguar një formë të mirë këtë edicion në FIBA Europe Cup. Synimi i kryeqytetasve është që të arrijnë sa më lart në këtë garë, kurse në edicionin e

kaluar regjistruan suksesin më të madh, duke u kualifikuar në Top 16. Takimi i së mërkurës do të jetë shumë interesant ndërmjet dy skuadrave që synojnë ta kalojnë grupin.



## Leverkuseni kërkon pikët e para




**LEVERKUSE, 5 NËNTOR** - Skuadra e Bayer Leverkuseni është në kërkim të fitores së parë në këtë edicion të Ligës së Kampionëve. Skuadra gjermane nga tri ndeshje nuk ka grumbulluar asnjë pikë dhe synon që këtë "mallkim" ta thyejë në ndeshjen që e zhvillon sonte (e mërkurë) kundër Atletico Madridit në "BayArena". Leverkuseni ka pësuar humbje nga tri skuadrat e Grupit D dhe gjasat për ta siguruar kualifikimin në raundin tjetër thuhet janë të pamundura, derisa Atletico Madridi kërkon fitore edhe në Gjermani në mënyrë që të jetë në garë me Juventusin për pozitën e parë në grup. Ndeshje e vështirë e pret edhe "Zonjën e Vjetër", sepse i shkon Lokomotiv Moscowit në Rusi. Në Grupin A Real Madridi në ndeshjen e kaluar ka shijuar

fitoren e parë me rezultat minimal ndaj Galatasarayt (0-1) dhe sërish synon tri pikë të reja për ta forcuar pozitën e dytë në grup, njëkohësisht për të pritur ndonjë gabim eventual nga PSG-ja që është e para. Francezët e presin skuadrën e Club Brugge me të cilën dy javë më parë arritën të dalin triumfues me rezultat të thellë 0-5. Në Grupin B Bayern Muncheni e pret fitoren e radhës ndaj Olympiacosit dhe kalimin në fazën tjetër, kurse për tri pikë luan edhe Tottenhami në Serbi ndaj Crvena Zvezdas. Në Grupin C Manchester City e ka "blinduar" pozitën e parë dhe përballet me radhës e zhvillon ndaj Atalantas në Itali, kurse dy skuadrat që po shtyhen për pozitën e dytë, Dinamo Zagrebi dhe Shakhtari, takohen në Kroaci.

GRUPI A		
21:00 PSG - Club Brugge		
21:00 Real Madrid - Galatasaray		
Tabela		
		PIKË
1. PSG	3	9
2. Real Madrid	3	4
3. Club Brugge	3	2
4. Galatasaray	3	1
GRUPI B		
18:55 Bayern M. - Olympiacos		
21:00 Crvena Zvezda - Tottenham H.		
Tabela		
		PIKË
1. Bayern M.	3	9
2. Tottenham	3	4
3. Crvena Zvezda	3	3
4. Olympiacos	3	1
GRUPI C		
21:00 Atalanta - Manchester City		
21:00 Dinamo Zagreb - Shakhtar D.		
Tabela		
		PIKË
1. Man City	3	9
2. Shakhtar	3	4
3. Dinamo Z.	3	4
4. Atalanta	3	0
GRUPI D		
18:55 Lokomotiv M. - Juventus		
21:00 Bayer Leverkusen - Atletico M.		
Tabela		
		PIKË
1. Atletico M.	3	7
2. Juventus	3	7
3. Lokomotiv M	3	3
4. Leverkusen	3	0

## Këndellet Houstoni

**HOUSTON, 5 NËNTOR** - Pas dy humbjeve radhazi në parketin e Brooklynit dhe Miami, Houstoni kthehet të buzëqeshë në kampionatin e NBA-s. Skuadra teksane mposhti Memphisin 107-100, një fitore që për momentin i shërben për të marrë frymë pak më lirisht. Russell Westbrook u la pushim nga trajneri Mike D'Antoni, kështu që i takoi James Hardeni që ta udhëheqë Rocketsin në këtë përballetje dhe Hardeni nuk zhgënjoi aspak dhe e mbylli sfidën me 44 pikë e 10 topa në tabelë. Por ai u bë protagonist i një incidenti me Crowderin që u përjashtua pasi e goditi i pari rivalin e vet. Memphis pati forcë që t'i rezistonte Houstonit deri në mesin e periodës së tretë dhe më i miri për këtë skuadër ishte Ja Morant me 23 pikë. Për Grizzliesin, në



kolonën e fitoreve vazhdon të shfaqet numri 1, sepse kjo skuadër ka vetëm një sukses në këtë sezon dhe këtë e regjistroi më 27 tetor ndaj Brooklynit vetëm pas kohës shtesë. Më në fund erdhi dita që shtëpia e re e Golden State, Chase Center në San Francisco ta festojë fitoren e parë të Warriorsit. Skuadra e drejtuar nga Steve Kerr mposhti Portlandin me rezultatin 127-118 në një sfidë ku iu desh të bënte pa emrat e mëdhenj si Curry, Thompson apo Russell. Kështu që i takoi debutuesit Eric Paschall

që të kthehej në heroin e Golden States duke festuar në mënyrë të mirë të mundshme ditëlindjen e tij teksa regjistroi një double-double me 36 pikë e 13 topa në tabelë. Golden State u duk në një ditë të mirë në këtë ndeshje teksa pa që pesë lojtarë të saj ta mbyllin sfidën me statistika dyshifrore. Te Portland Damian Lillard shënoi 39 pikë, ndërsa Hassan Whiteside 22, por ishin shumë pak për Trailblazersin për ta evituar humbjen.

REZULTATET	
Washington Wizards - Detroit Pistons	115-99
Brooklyn Nets - New Orleans Pelicans	135-125
Memphis Grizzlies - Houston Rockets	100-107
Minnesota Timberwolves - Milwaukee Bucks	106-134
Phoenix Suns - Philadelphia 76ers	114-109
Golden State Warriors - Portland Trail Blazers	127-118

### SHKURT

#### Trajneri i Çekisë: Do të arrijmë fitore ndaj Kosovës

Trajneri i Çekisë, Jaroslav Silhavy, shpreh optimizëm se do të arrijë fitore në përballetjen kundër Kosovës. Ndeshja Çeki-Kosovë zhvillohet më 14 nëntor në "Doosan Arena" dhe do të jetë vendimtare për fatin e të dyja Kombëtareve në Grupin A kualifikues për Kampionatin Evropian 2020. "Me Kosovën është një ndeshje shumë e rëndësishme për të gjithë ne, prandaj do t'i hyjmë takimit me motivimin më të madh të mundshëm. Besoj se do të arrijmë fitoren. Ne e dimë çfarë do të presim nga ndeshja me Kosovën, prandaj besojmë se do të jemi të gatshëm për ta menaxhuar takimin", ka thënë Silhavy.

#### Icardi: Dua të qëndroj në Paris Saint-Germain

Sulmuesi Mauro Icardi nuk është i interesuar të rikthehet në skuadrën e Interit, por të qëndroj në Paris Saint-Germain. "Të luadh për PSG-në është diçka e madhe, është njëri ndër klubet më të mëdha në botë. Do të bëjë gjithçka që të qëndroj këtu. Dua të tregoj se çfarë mund të jap në fushë. Tetori ishte një muaj pozitiv", ka thënë Icardi. "E di se duhet të bëjë ende më shumë, duhet të vazhdoj edhe në muajt e ardhshëm. Do të shohim nëse do të qëndroj kur të përfundoj sezoni. Këtu ka shumë gjëra që dua t'i bëjë. Kjo është arsyeja se përse jam këtu", ka shtuar Icardi.

#### Grosso, trajner i Brescias

Brescia e ka konfirmuar Fabio Grosson si trajner të ri, pasi Eugenio Corini u shkarkua në fundjavë. 42-vjeçari fillimisht u desh të arrinte marrëveshjen me Veronan për ta përfunduar kontratën e tij, që ishte në fuqi edhe pse ishte larguar nga klubi. "Verona ka arritur marrëveshje për të përfunduar kontratën me Fabio Grosson", ka shkruar Verona në një njoftim në faqen zyrtare të klubit. Grosso do të nisë punën e tij të re në ndeshjen e së shtunës ndaj Torinos në shtëpi.


#### Ten Haag: Nuk largohem nga Ajaxi

Trajneri i Ajaxit, Erik ten Haag ka folur për mundësinë që t'i bashkohet skuadrës së Bayern Munchen. Ai ka thënë se nuk do të largohet në këtë edicion nga skuadra holandeze, ani pse e vlerëson shumë skuadrën gjermane. "Bayerni është një ekip fantastik, e kam shijuar shumë kohën time atje. Ka një vend të veçantë në zemrën time. Por tani jam te Ajax dhe këtu jam i përqendruar. Kam një marrëdhënie shumë të mirë me lojtarët e mi dhe ju konfirmoj që këtë sezon do qëndroj këtu", ka thënë Erik Ten Haag.

#### Mane: Kemi pasur mosmarrëveshje me Salahin

Sadio Mane pranon se ka pasur mosmarrëveshje me Mohamed Salah në Liverpool, por thotë se shoku i tij është i jashtëzakonshëm dhe mbetet një kënaqësi e madhe për të luajtur përkrah tij. Dy yjet në 'Anfield' kanë pasur probleme herë pas here, me emocionet që shpërthyen gjatë ndeshjes kundër Burnley në fillim të këtij sezoni. "Ai është një golashënues i çmendur dhe një lojtar i jashtëzakonshëm që mund të bëjë gjithçka. Ne ndonjëherë kemi pasur mosmarrëveshjet tona, por mbetet kënaqësi e madhe të luajmë pranë tij sepse kam ndjenjën se flasim të njëjtin lloj futbolli", ka thënë Mane.





<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	ENERGJIK, I SHKATHËT	NGJALLJE E KUJTIMEVE PËR DIKË (sh.shq.)	LLOJ DEVE E VENDEVE TË AMERIKËS JUGORE (sh.shq.)	ALBANOLOGIA .... DURHAM	GROUP INTERACTIVE NETWORKS	PJESËTAR I NJË FISI ILIR	PJESËTAR I NJË POPULLI NË SRI LANKË	<b>EPOKA ERE</b>	SHTËPIA E BANIMIT	SHKRIMTARI .... ZOLA	"... VEGAS"
PËRFAQËSUES I ZGJEDHUR NGA NJË ORGANIZATË								PJESA MË E NGUSHTË E TRUPIT TË NJERIUT, MESI (pashq.)			
I UJITA								GURRA			
EMËRIM NË NJË DETYRË FUQI, FORCË (krah.)								FILLOJ NËNSHTRIM I PLOTË			
						LARTËSI E NJË LËNGU NË NJË ENË FLORI, DUKAT					LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE
GOJËDHËNË					PËRMBLEDH- JE HARTASH GJEOGRAFIKE VEÇORI THELBËSORE E NJË SENDI					BASHKËT. ORGAN I FEMRËS, GJI (shq.)	
ISMET MUNISHI				DIREK I ÇATISË VLERËSIMI I NXËNËSIT ME NOTË				VËLLIMI, MASË GUID PARTITION TABLE			
SHTET NË AFRIKË (pashq.)						PREJ KU LUTJA QË I BËHET ZOTIT (mysl.)			IGLI TARE ZANORE		

<b>EPOKA ERE</b>	TRAJNERI NË FOTO QË IA SOLLI 'LA DECIMA-n REAL MADRIDIT	QILIM I VOGËL QË SHTROHET NË NJË ANË TË OXHAKUT (shq.)	VENDI KU NDIZET ZJARRI	ALYSSA MILANO	FUTBOLLIST I NJOHUR PORTUGEZ (MANCHESTER UNITED)	DIPLOMATI FINLANDEZ ... REHN	ARMË E RËNDË LUFTE ISH FUTBOLLISTI ZIDAN		QELESHJA DIJETARI FETAR MYSLIMAN				
ENË QELQI E RRUMBULLAK- ËT SI SHISHE, PO ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK	○											ADRIAN KRASHIQI BASHKËT.	
ARKEOLOGU YNË SKËNDER	○							INTENSTET, RADIUM, LITËR SHALQI		LLOJ REVOLEJE BASHKËT.		ZANORE GDHENDA	
RITUAL	○			AGJËRIM (krah.) REPËRTI I SPITALIT KU LINDIN FOSHNJAT					KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE E IMËT DY BASHKË- TINGËLLORE			DY BASHKË- TINGËLLORE REGJISORI .... STONE (shq.)	
TË QENËT I LARMË, TË QENËT LARA- LARAMANI	○					REPER I NJOHUR AMERIKAN OHAJO, LUIZIANA				NJË PLANET BASHKËT.			
ZANORE	○	ALI ALIU KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE .... ROSS			FUTBOLLISTI ITALIAN MASIMO ... AGIM TEJECI		YLL FILMI I TURPËROJ				NOTË MUZIKORE DANISH AIR TRANSPORT		QË NXË NJË OKË (shq.)
AFËRDITA DRESHAJ	○		KRYEQYTETI I ESTONISË BREJTËS I VOGËL					ISMET JASHARI I SHASTISUR; I HUTUAR		KËNGËTARJA ROVENA ... VITI I RI KINEZ (pashq.)			
BEREQET	○				MODELJA AMERIKANE .... TAYLOR TEFTA TASHKO			QË KA TË BËJË ME ATAVIZMIN FRIKAKAKU, IKANAKU					
LAGJE NË SHKUP	○				TROYES SOLISTJA BYTYQI		TRUP GJEOMETRIK VEZAKE			PARA TË NËNTËS ELEKTRON, TANTAL, REOMIR			
ESTONIA, NORVEGJIA	○		PESHA E MALLIT PA AMBALAZH MAJA E MPREHTË E NJË MALI (sh.shq.)					HARAC RAVENA			RADIUM, TON GATESE E JONA (sh.shq.)		
LAKESË	○				ZGAVËR NË TOKË (sh.shq.) DEM, TER					3.14 (Mat.) SHEGË		ZANORE KËNGËTARI AMERIKAN .... BROWN (shqip.)	
OTRANTO	○	VENDLINDJA E ODISEUT MA JEP						VIGANI, KOLOSI BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA				KADRI ROSHI NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE	
KËNGËTARJA JONË ANITA ....	○				LETRARI PODRIMJA ALUMIN			LLOJ KOSI ME HUDHRA DRITA OSMANI					
I PESHOVA	○				PUNUAR NË VEGJË (PËLHURË A RROBË) ZANORE				BAKRI SUEDIA			ZANORE	
<b>EPOKA ERE</b>	PRIJËS I HUNËVE						EURO DEPUTETJA .... PACK			LUMË I MADH NË HUNGARI			





**ODA E NOTERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**NOTARSKA KOMORA REPUBLIKE KOSOVA / NOTARY CHAMBER OF THE**  
**REPUBLIC OF KOSOVO**

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Odës së Noterëve, të datës 02.11.2019, nenin 63 par. 2.4 të Ligjit Nr. 06/L-010, për Noterinë, nenin 19 par. 3.25 të Statutit të Odës së Noterëve, Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve të Kosovës, me datë 06.11.2019 bënë këtë:

**SHPLLJE PUBLIKE PËR SHPREHJE TË INTERESIT**

Oda e Noterëve të Kosovës, bënë ftesë publike për palët e interesuara për dorëzimin e ofertave për **blerjen e parcelës/ave për nevoja të ndërtimit të selisë së ONK-së**.

Oferta duhet të përfshijë, por pa u kufizuar;

- Sipërfaqen prej 8 deri 10 ari;
- Çmimin për ari;
- Dëshmi të dokumentacionit pronësorë;
- Përgjigjen në kërkesë nga Komuna e Prishtinës mbi plani rregullues të pronës.

Lokacionet e preferuara: Prishtina e Re, Arbëria, Bregu i Diellit, Emshir, Çagllavicë, afër Pallatit të Drejtësisë, si dhe distancat e përafërta.

Ofertat dhe dokumentet përcjellëse pranohen gjatë periudhës sa është e hapur shpallja publike, nga data 06 – 20 Nëntor 2019, nga ora 08:30-16:00 në selinë e ONK-së, adresë Rr. "Bashkim Fehmiu", OB-13-BL-A, C10, Hyrja 2, Kati i 4-të, banesa nr. 21, Arbëri, Prishtinë.

Ofertat dhe dokumentet përcjellëse mund të dorëzohen personalisht në kopje fizike ose edhe në e-mailin [info@noteria-ks.org](mailto:info@noteria-ks.org) me kusht që secili dokument të jetë i nënshkruar.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/VLADA KOSOVA  
 MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-  
 MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

**NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURISIT**

Bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës, me Nr. të Protokolit 406, të datës 22.10.2019, për miratimin e dorëheqjes së kandidatit të përzgjedhur për pozitën Drejtor Artistik në TKK dhe shfuqizimin e vendimit të datës 21.06.2019, me Nr. protokoli 2597/2019, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bënë njoftimin për anulimin e konkursit të shpallur me datë, 22.05.2019, për pozitën Drejtor Artistik në Teatrin Kombëtar të Kosovës .

**OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA**

Na osnovu Odluke Upravnog Saveta Nacionalnog Pozorišta Kosova, br. Protokola 406, datuma 22.10.2019, kojim se odobrava ostavka kandidata koji je izabran za mesto Umetničkog Direktora u NPK-i i ukidanju odluke od 21.06.2019, br. Protokola 2597/2019, Ministarstvo kulture, omladine i sporta, objavljuje anuliranje konkursa objavljenog dana 22.05.2019 za mesto Umetničkog Direktora u Nacionalnom Pozorištu Kosova.

**>> SHPLLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Raffles" Sh.p.k Tërnoc, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit në Shupkoc, Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.12.2019 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Koha" afër urës së Ibrit në Mitrovicë do të organizohet debat publik nga kompania "Raffles" Sh.p.k Tërnoc, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit në Shupkoc, Mitrovicë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1906

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1906  
0.5L